



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

www.qpz.gov.al

Nr.141

11 shtator

2008

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i KM nr.1188, datë 20.8.2008	Për miratimin e rregullave për importimin, tregtimin, transportin, ruajtjen, përdorimin dhe asgjësimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve..... 6263
Vendim i KM nr.1211, datë 27.8.2008	Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, bursat e shtetit dhe pagesat e nxënësve dhe të studentëve, në institucionet arsimore publike, për vitin shkollor 2008-2009..... 6284
Vendim i KM nr.1212, datë 27.8.2008	Për dhënien e bursave për nxënësit e shkollës së mesme profesionale “Peter Mahringer”, Shkodër, për vitin shkollor 2008-2009..... 6290
Vendim i KM nr.1215, datë 9.7.2008	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i nënstacionit të Gjirokastrës..... 6290
Vendim i KM nr.1219, datë 3.9.2008	Për një shtesë dhe ndryshim në vendimin nr.335, datë 2.9.1997 të Këshillit të Ministrave “Për lëshimin e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit”, të ndryshuar.. 6293
Vendim i KM nr.1220, datë 3.9.2008	Për hapjen e programeve të studimit, të ciklit të dytë, pranë Universitetit Politeknik të Tiranës, në vitin akademik 2008-2009..... 6293
Vendim i KM nr.1221, datë 3.9.2008	Për hapjen e programeve të studimit, të ciklit të dytë, pranë Universitetit Bujqësor të Tiranës, në vitin akademik 2008-2009..... 6294
Udhëzim i MF nr.26, datë 4.9.2008	Për taksat kombëtare..... 6295

VENDIM
Nr.1188, datë 20.8.2008

**PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR IMPORTIMIN, TREGTIMIN, TRANSPORTIN,
RUAJTJEN, PËRDORIMIN DHE ASGJËSIMIN E PRODUKTEVE PËR MBROJTJEN E
BIMËVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 26 të ligjit nr.9362, datë 24.3.2005 “Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. PËRKUFIZIME

Në këtë vendim termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Import” nënkupton futjen në territorin e Republikës së Shqipërisë të çdo produkti për mbrojtjen e bimëve (PMB), të regjistruar.
2. “Tregtim” nënkupton çdo veprimtari për transportin, magazinimin, shpërndarjen, paraqitjen për shitje ose shitjen, në territorin e Republikës së Shqipërisë, të çdo produkti për mbrojtjen e bimëve, të regjistruar.
3. “Leje importi” nënkupton dokumentin zyrtar, që lëshohet për të lejuar importin e PMB-ve në Republikën e Shqipërisë.
4. “Leje tregtimi” nënkupton dokumentin zyrtar, që lëshohet për të lejuar tregtimin e PMB-ve, brenda Republikës së Shqipërisë.
5. “Reklamim” nënkupton promovimin e shitjes ose të shfrytëzimit të çdo PMB-je, përmes mediave të shkruara, audiovizive, shenjave, afisheve, dhuratave.
6. “Ambalazhim i produkteve për mbrojtjen e bimëve” nënkupton materialin e një konteneri, ambalazhet në pako apo mjete të mbyllura, përfshirë edhe materialet në kontakt me PMB-në.
7. “Punëdhënës” nënkupton personin, që punëson, drejton, mbikëqyr ose kontrollon një a më shumë persona në tregtimin dhe/ose përdorimin e PMB-ve.
8. “Etiketë” nënkupton përmbajtjen e shkruar grafike, të shtypur në/ose, që u bashkëlidhet PMB-ve drejtpërdrejt në ambalazhin e jashtëm dhe në paketimin e enës a të kutisë bazë të PMB-së.
9. “Përdorues i fundit” nënkupton personin ose subjektin, që merret me përdorimin e PMB-ve, në përputhje me kërkesat e këtij vendimi.
10. “Përdorues profesionist” nënkupton çdo person, të autorizuar, të përdorë PMB, të klasifikuar “PMB me rrezik të lartë”, në përputhje me kërkesat e këtij vendimi.
11. “Mjete mbrojtëse individuale (MMI)” nënkupton mjetet mbrojtëse, që përdoren gjatë ruajtjes, tregtimit dhe përdorimit të PMB-ve, të përcaktuara, në shtojcën 15, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
12. “PMB të tjera” nënkupton PMB-të, që nuk përfshihen në pikat 4.1 e 4.2 të nenit 2 të ligjit nr.9362, datë 24.3.2005 “Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve”, të ndryshuar.

II. IMPORTIMI I PRODUKTEVE PËR MBROJTJEN E BIMËVE

1. Lejohet vetëm importimi i PMB-ve, të regjistruara në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për regjistrimin e tyre.
2. Personat, që kërkojnë të importojnë PMB, të klasifikuara “PMB të tjera”, paraqesin, në strukturën përgjegjëse të mbrojtjes së bimëve (SPMB), formularin e vetëdeklarimit, sipas shtojcës 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Personat, që kërkojnë të importojnë PMB, të klasifikuara “PMB të rrezikshme” dhe “PMB me rrezik të lartë”, pajisen me “Leje importi”, nga drejtuesi i SPMB-së, pas paraqitjes së dokumenteve të mëposhtme:
 - a) Kërkesës sipas shtojcës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;
 - b) Diplomës së agronomit, të vetë atij ose të personit të punësuar, si dhe listën e punonjësve të punësuar;
 - c) Dokumentit të miratimit të magazinës së tregtimit me shumicë të PMB-ve, sipas

përcaktimeve të pikës 5 të kreut IV të këtij vendimi;

ç) Dokumentit të miratimit, nga Inspektorati i Mbrojtjes së Bimëve, të pajisjeve, që do të përdoren për magazinimin e PMB-ve;

d) Të dhënat, që garantojnë se shëndeti dhe siguria e personelit janë të mbrojtura në çdo kohë;

dh) Dokumentit të konfirmimit shëndetësor, nga organet e shëndetësisë, se personi në fjalë, si dhe ata të punësuar prej tij, janë të aftë të punojnë me këto PMB.

4. Të dhënat, që duhet të përmbajë leja e importit, përcaktohen në shtojcën 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Leja e importit vendoset në mjediset përkatëse, në mënyrë të dukshme dhe të përherëshme.

6. Drejtuesi i SPMB-së miraton të drejtën e importimit brenda një kohe të arsyeshme, por jo më vonë se 5 ditë nga data e marrjes së kërkesës, së bashku me dokumentet e përcaktuara në pikën 3 të këtij kreu. Në rast mosmiratimi, drejtuesi i SPMB-së njofton me shkrim personin e interesuar, duke renditur edhe arsyet e marrjes së këtij vendimi.

7. Afati i vlefshmërisë së lejes së importit për PMB-të e klasifikuara “PMB të rrezikshme” dhe “PMB me rrezik të lartë” është tre vjet.

Drejtuesi i SPMB-së mund ta shtyjë këtë afat, pas kërkesës së aplikuesit, kur e gjykon se vazhdojnë të plotësohen kërkesat e pikës 3 të këtij kreu.

8. Çdo person i pajisur me leje importi për PMB, të klasifikuara “PMB të rrezikshme” dhe “PMB me rrezik të lartë”, është i detyruar:

a) të hartojë një raport vjetor (dhe ta paraqesë atë te SPMB-ja jo më vonë se muaji shkurt i vitit pasardhës) për sasinë dhe cilësinë e çdo PMB-je, që ka importuar dhe hedhur në treg gjatë vitit të mëparshëm kalendarik;

b) të vërë në dijeni me shkrim SPMB-në për çdo ndryshim në të dhënat e paraqitura në çastin e marrjes së lejes së importit;

c) të vërë në dijeni SPMB-në, për çdo efekt të dëmshëm te përdoruesi, që është vërejtur gjatë përdorimit ose ekspozimit ndaj secilit PMB, të importuar dhe të hedhur në treg;

ç) të vërë në dijeni SPMB-në, për çdo efekt të dëmshëm, të paparashikuar, mbi mjedisin apo ekosistemin, si rezultat i përdorimit, përhapjes, shkarkimit etj., të PMB-ve të importuara dhe të hedhura në treg;

d) të vërë në dijeni SPMB-në, për çdo efekt të dëmshëm, të paparashikuar, mbi njerëzit ose kafshët, nga konsumi i bimëve apo i produkteve bimore, që përmbajnë mbetje të PMB-ve, të importuara dhe të hedhura në treg;

dh) të lejojë në çdo kohë inspektoratin fitosanitar, inspektoratin e mjedisit dhe atë sanitar të hyjnë për të kontrolluar mjediset, ku ndodhen PMB-të, dhe vetë PMB-të.

9. Çdo person i pajisur me leje importi, që kërkon të importojë PMB, të klasifikuara “PMB të rrezikshme” dhe “PMB me rrezik të lartë”, duhet të njoftojë më parë SPMB-në, për çdo ngarkesë.

Njoftimi bëhet sipas një formulari, i cili përmban:

a) emrin tregtar dhe numrin e paketimit të PMB-së;

b) numrin dhe datën e regjistrimit;

c) vendin e origjinës;

ç) emrin e prodhuesit;

d) sasinë;

dh) datën dhe vendin nga importohet;

e) pikën e kalimit kufitar nga do të futet në territorin e Republikës së Shqipërisë.

10. Njoftimi bëhet me shkrim jo më vonë se 10 ditë para datës së hyrjes së tyre në Republikën e Shqipërisë.

11. SPMB-ja publikon, në fillim të çdo viti, listën e importuesve të PMB-ve, të miratuar sipas kërkesave të këtij vendimi.

Kjo listë përmban këto të dhëna:

a) emrin e shoqërisë;

b) emrin, mbiemrin e pronarit të shoqërisë;

c) adresën (vendndodhjen) e zyrave dhe të magazinës;

ç) numrin e lejes së importit dhe datën e dhënies së saj.

III. TREGTIMI I PRODUKTEVE PËR MBROJTJEN E BIMËVE

1. Lejohet vetëm tregtimi i PMB-ve të regjistruara në përputhje me legjislacionin në fuqi për

regjistrimin e këtyre produkteve.

2. Personat, që kërkojnë të tregtojnë PMB, të klasifikuara “PMB të tjera”, paraqesin, në drejtorinë rajonale të bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit (DRBUMK), formularin e vetëdeklarimit, sipas shtojcës 6, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Personat, që kërkojnë të tregtojnë PMB, të klasifikuara “PMB të rrezikshme” dhe “PMB me rrezik të lartë”, pajisen me leje tregtimi, të lëshuar nga drejtori i DRBUMK-së, pas paraqitjes së dokumenteve të mëposhtme:

- a) Kërkesës, sipas shtojcës 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi;
- b) Diplomës së agronomit, të vetë atij ose të personit të punësuar. Për tregtimin me shumicë kërkohet edhe lista e personave të punësuar;
- c) Dokumentit të miratimit të magazinës, sipas përcaktimeve të pikës 5 të kreut IV apo të objekteve të njërive të tregtimit me pakicë, sipas përcaktimeve të pikës 9 të kreut IV, të këtij vendimi;
- ç) Dokumentit të miratimit paraprak, nga Inspektorati i Mbrojtjes së Bimëve, të pajisjeve të nevojshme, që do të përdoren për magazinimin ose shitjen e PMB-ve;
- d) Të të dhënave, që garantojnë se shëndeti dhe siguria e personelit janë të mbrojtura në çdo kohë;
- dh) Konfirmimit shëndetësor, nga organet e shëndetësisë, se ai dhe të punësuarit prej tij janë të aftë të punojnë me këto PMB.

4. Të dhënat, që duhet të përmbajë leja e tregtimit, përcaktohen në shtojcën 5, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Leja e tregtimit vendoset në mjediset përkatëse në mënyrë të dukshme dhe të përherëshme. Një kopje e noterizuar e lejes është e domosdoshme edhe gjatë transportit të PMB-ve.

6. Drejtori i DRBUMK-së miraton të drejtën e tregtimit brenda një kohe të arsyeshme, por jo më vonë se 5 ditë nga data e marrjes së kërkesës, dhe të dokumentacionit të përcaktuar në pikën 3 të këtij kreu.

7. Në rast mosmiratimi, drejtori i DRBUMK-së vë në dijeni, me shkrim, personin e interesuar, duke dhënë edhe arsyet e refuzimit.

8. Afati i vlefshmërisë së lejes së tregtimit për PMB-të, të klasifikuara “PMB të rrezikshme” dhe “PMB me rrezik të lartë”, është pesë vjet. Drejtori i DRBUMK-së mund ta zgjasë këtë afat pas kërkesës së aplikuesit, kur gjykon se vazhdojnë të plotësohen kërkesat e pikës 3 të këtij kreu.

9. Njësitë e tregtimit me pakicë shërbejnë për shitjen e drejtpërdrejtë të PMB-ve te përdoruesi i fundit.

10. Në njësitë e tregtimit me pakicë ndalohej:

- a) shitja e PMB-ve, të klasifikuara “PMB të rrezikshme”, personave që nuk janë të pajisur me dëshmi aftësie, dhe “PMB me rrezik të lartë”, personave, që nuk janë të pajisur me dëshmi aftësie të veçantë (përdorues profesionistë);
- b) shitja e PMB-ve, të klasifikuara “PMB të rrezikshme” dhe “PMB me rrezik të lartë”, pa recetë të lëshuar nga specialistët përkatës, sipas përcaktimeve të pikës 19 të këtij kreu;
- c) mbajtja e PMB-ve në ambalazhe joorigjinale;
- ç) asgjësimi i ambalazheve dhe i PMB-ve të skaduara apo të dëmtuara;
- d) mbajtja dhe tregtimi i ushqimeve për njerëz dhe për kafshë, si dhe i farërave;
- dh) riambalazhimi i PMB-ve.

11. Në njësitë e tregtimit me pakicë shitja bëhet vetëm nga specialistët e përmendur në shkronjën “b” të pikës 3 të këtij kreu.

Veprimtaria e njërive të tregtimit me pakicë pasqyrohet në një libër të veçantë, sipas shtojcës 8, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Në libër bashkëlidhen edhe recetat e lëshuara sipas pikës 21 të këtij kreu.

12. Pronari i njësisë së tregtimit ose personi i punësuar prej tij është i detyruar të vërë në dispozicion të Inspektoratit të Mbrojtjes së Bimëve, gjatë kontrollit, të gjithë dokumentacionin e kërkuar.

13. Të dhënat, që mbahen nga njësitë e tregtimit, me shumicë dhe pakicë, për PMB-të, e klasifikuara “PMB të rrezikshme” ose “PMB me rrezik të lartë”, përfshijnë informacionin e mëposhtëm:

- a) Emrin tregtar të PMB-së, që tregtohet ose manipulohet;

b) Sasinë dhe numrin e paketimit të PMB-së, që tregtohet;
c) Hollësitë e nevojshme për të identifikuar kur dhe ku është marrë PMB-ja dhe ku është shitur kjo PMB (sipas rastit: emri i prodhuesit, i njësisë së tregtimit me shumicë, i njësisë së tregtimit me pakicë dhe i përdoruesit).

14. DRBUMK-ja publikon, në fillim të çdo viti, listën e njësive të tregtimit, me shumicë dhe pakicë, të miratuara, sipas kërkesave të këtij vendimi.

Kjo listë përmban:

- a) emrin e njësive së tregtimit;
- b) emrin e mbiemrin e pronarit;
- c) emrin e mbiemrin e personit të punësuar (kur ka të tillë);
- ç) adresën (vendndodhjen) e njësive së tregtimit;
- d) numrin e lejes së tregtimit dhe datën e dhënies së saj.

15. Çdo person i pajisur me leje tregtimi për PMB-të, të klasifikuara “PMB të rrezikshme” dhe “PMB me rrezik të lartë”, duhet:

a) të hartojë një raport vjetor (dhe ta paraqesë te DRBUMK-ja jo më vonë se muaji janar i çdo viti) për sasinë dhe cilësinë e secilit PMB, që ai ka hedhur në treg gjatë vitit të mëparshëm kalendarik;

b) të vërë në dijeni, me shkrim, inspektoratin e mbrojtjes së bimëve, të DRBUMK-së, për çdo ndryshim në informacionin e dhënë në çastin e marrjes së lejes së tregtimit;

c) të vërë në dijeni inspektoratin e mbrojtjes së bimëve, të DRBUMK-së dhe atë sanitar, për çdo efekt të dëmshëm të përdoruesi, që është vërejtur gjatë përdorimit ose ekspozimit ndaj secilit PMB, të hedhur në treg;

ç) të vërë në dijeni inspektoratin e mbrojtjes së bimëve, të DRBUMK-së dhe atë të mjedisit, për çdo efekt të dëmshëm, të paparashikuar, në mjedis apo në ekosistem, si rezultat i përdorimit, përhapjes, shkarkimit e hedhjes në treg të PMB-së;

d) të vërë në dijeni inspektoratin e mbrojtjes së bimëve, të DRBUMK-së dhe atë sanitar, për çdo efekt të dëmshëm, të paparashikuar, të njerëzit ose kafshët, nga konsumimi i bimëve apo i produkteve bimore, që përmbajnë mbetje të PMB-ve, të hedhura në treg;

dh) të lejojë inspektoratin e mbrojtjes së bimëve të DRBUMK-së, inspektoratin e mjedisit dhe atë sanitar të kryejnë kontroll, në çdo kohë, në mjediset e magazinimit të PMB-ve apo dhe të vetë këtyre produkteve.

16. Shitja PMB-ve në njësitë e tregtimit me pakicë përdoruesve profesionistë kryhet në bazë të recetës së lëshuar nga personat e përcaktuar në pikën 17 të këtij kreu.

17. Receta plotësohet nga specialisti, i diplomuar agronom.

18. Lëshuesi i recetës mban përgjegjësi për dëmin e shkaktuar te bimët ose produktet bimore, të trajtuara, në rast plotësimi të pasaktë të saj.

19. Receta plotësohet në tri fletë, një origjinale dhe dy kopje, dhe përmban:

- a) emrin, mbiemrin dhe adresën e lëshuesit të saj;
- b) sëmundjen, prekjat parazitare ose barërat e këqija etj., që mendohen të luftohen;
- c) dozat e përdorimit të PMB-së;
- ç) kohën e pritshmërisë (karenca);
- d) kulturën ose produktin bimor, tek i cili do të përdoret;
- dh) kohën, sasinë dhe mënyrën e përdorimit.

20. Në çdo rast, nuk mund të përshkruhen me tepër se tri PMB në një recetë.

21. Receta origjinale dorëzohet në inspektoratin e mbrojtjes së bimëve, të DRBUMK-së, ndërsa, nga dy kopjet e tjera, njërën e mban njësia e tregtimit me pakicë, të cilën ia bashkëlidh librit të saj, ndërsa tjetrën përdoruesi i PMB-ve.

IV. RUAJTJA E PRODUKTEVE PËR MBROJTJEN E BIMËVE

1. PMB-të ruhen në magazina dhe në njësitë përkatëse të tregtimit me pakicë (farmacitë bujqësore).

2. Magazinat e PMB-ve janë objekte, që shërbejnë për ruajtjen dhe shitjen e tyre te njësitë e tregtimit me pakicë.

3. Magazinat ndërtohen mbi 500 m larg shkollave, shtëpive, spitaleve, qendrave tregtare, magazinave ushqimore, për njerëz dhe kafshë, pikave të karburanteve (PMB-të e ndezshme) dhe fabrikave të përpunimit të ushqimeve, si dhe mbi një km larg ujërave të rrjedhshme dhe baseneve ujore. Këto magazina rrethohen me mur të lartë (2 m). Muri rrethues është 3 m larg ndërtesës së

magazinës. Jashtë murit rrethues, rreth e qark tij, bëhet një kanal, me parete anësore të betonuara, i thellë një metër dhe i gjerë jo më pak se 50 cm.

4. Magazinat duhet të ndërtohen ose përshtaten në mënyrë të tillë, që të garantojnë ruajtjen e cilësive fiziko-kimike të PMB-ve, të sigurojnë një temperaturë të mjedisit, sipas kërkesave të caktuara në etiketën e PMB-ve, për ruajtjen dhe magazinimin e tyre. Për këtë qëllim magazinat duhet të jenë të pajisura me sisteme ajrimi, aparate matëse dhe regjistruese të temperaturës (termometër) dhe të lagështisë së ajrit (hygrometër).

5. Për funksionimin e magazinave të tregtimit me shumicë të PMB-ve jepet miratimi nga:

- a) Inspektorati i Mbrojtjes së Bimëve të DRBUMK-së;
- b) Inspektorati Sanitar Shtetëror;
- c) Strukturat përkatëse të Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave;
- ç) Policia e Shtetit.

6. Kërkesat, që duhet të plotësohen për magazinimin e PMB-ve, janë si më poshtë vijon:

a) Të jenë të identifikuara, nëpërmjet certifikatës së origjinës dhe të cilësisë.

b) Hyrja/dalja nga magazina bëhet me dokumente të rregullta dhe shënimet përkatëse pasqyrohen në librin e magazinës, sipas shtojcës 7, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Ky libër, bashkë me fletëhyrjet dhe fletëdaljet, ruhet për pesë vjet.

c) Të vendosen në paletë të ndara nga njëra-tjetra, në një largësi jo më të vogël se 0.5 m, të ambalazuara në mënyrë të rregullt, në ambalazhe origjinale dhe me etiketat e miratuara, sipas dokumentit të regjistrimit të PMB-së.

ç) PMB-të e lëngëta vendosen në lartësi jo më të madhe se 2.5 m, ndërsa PMB-të e ngurta vendosen në lartësi deri 2 m, për të mënjeluar dëmtimin nga pesha.

d) Punonjësit e magazinave të PMB-ve duhet të jenë të pajisur me dëshmi aftësie, kur punojnë me PMB, të klasifikuara “PMB të rrezikshme”, dhe dëshmi aftësie të veçantë, kur punojnë me “PMB me rrezik të lartë”.

7. Në këto magazina ndalohet:

- a) mbajtja dhe tregtimi i ushqimeve për njerëz dhe për kafshë, si dhe i farërave;
- b) riambalazhimi i PMB-ve;
- c) shitja e PMB-ve me pakicë të përdoruesi i fundit;
- ç) asgjësimi i ambalazheve, si dhe i PMB-ve të skaduara apo të dëmtuara.

8. Magazinat dhe njësitë e tregtimit me pakicë (farmacitë bujqësore) të PMB-ve janë të pajisura, detyrimisht, me:

- a) mjetet e nevojshme për shuarjen e zjarreve, asgjësimin e PMB-ve të rrjedhura;
- b) këndin e ndihmës së shpejtë dhe mjetet mbrojtëse individuale;
- c) mjediset higjieno-shëndetësore me ujë të rrjedhshëm etj.;
- ç) mjediset të veçanta qëndrimi për punonjësit e tyre.

9. Miratimi i objekteve të njësisë të tregtimit me pakicë të PMB-ve bëhet nga inspektorati i mbrojtjes së bimëve, të DRBUMK-së.

10. Njësitë e tregtimit me pakicë të PMB-ve duhet të ndërtohen ose të përshtaten në mënyrë të tillë që të garantojnë ruajtjen e cilësive fiziko-kimike të tyre, të sigurojnë një temperaturë mjedisi, sipas kërkesave të caktuara në etiketën e PMB-ve për ruajtjen e tyre. Për këtë qëllim, ato janë të pajisura me sisteme ajrimi, aparate, matëse dhe regjistruese, të temperaturës (termometër) dhe të lagështisë së ajrit (hygrometër).

11. Kur gjatë ruajtjes së PMB-ve në magazina ose në njësitë e tregtimit me pakicë ndodhin dëmtime të ambalazheve dhe rrjedhje të PMB-ve, ato largohen menjëherë nga magazina e njësisë e tregtimit dhe asgjësohen.

12. Nëse PMB-të, brenda ambalazheve të dëmtuara, janë në gjendje të mirë, ato futen në ambalazhe me etiketa origjinale, në prani të inspektorit të mbrojtjes së bimëve, të DRBUMK-së. Ky veprim shoqërohet me mbajtjen e një procesverballi, në dy kopje, për të mënjeluar abuzimet, që mund të ndodhin me riambalazhimin e PMB-ve në këto mjedisë.

13. Përdoruesit e fundit i ruajnë PMB-të në mjediset të veçanta, si në kasaforta, dhoma, depo të siguruara nga hapjet e paautorizuara, në ambalazhe origjinale, larg fëmijëve, në kushte të thata, larg zjarrit, të mbrojtura nga rrezet e drejtpërdrejta të diellit, si dhe duke respektuar të gjitha udhëzimet e veçanta, që jepen në etiketë.

V. PËRDORIMI I PRODUKTEVE PËR MBROJTJEN E BIMËVE

1. Të drejtën për të përdorur (përdoruesi i fundit) PMB-të, të klasifikuara “PMB të tjera”, e kanë të gjithë personat, me moshë mbi 18 vjeç, me përjashtim të grave shtatzëna, deri në fund të periudhës së laktacionit.

2. Të drejtën për të përdorur PMB, të klasifikuara “PMB të rrezikshme”, e kanë të gjithë personat, që plotësojnë kërkesat e pikës 1 të këtij kreu, dhe që janë të pajisur me dëshmi aftësie.

3. Të drejtën për të përdorur PMB të klasifikuara “PMB me rrezik të lartë”, e kanë të gjithë personat, që plotësojnë kërkesat e pikës 1 të këtij kreu, dhe që janë të pajisur me dëshmi aftësie të veçantë. Këto persona quhen përdorues profesionistë.

4. Përgatitja dhe instruktimi i personave, që kërkojnë të pajisen me dëshmi aftësie, bëhen nga inspektorati i mbrojtjes së bimëve, pranë DRBUMK-së, në bashkëpunim me specialistë të shërbimit këshillimor, sipas një tematike të hartuar nga kjo drejtori.

5. Komisioni i ngritur pranë DRBUMK-së vlerëson njohuritë e personit, që kërkon dëshminë e aftësisë për problemet e mëposhtme:

a) njohuri për përdorimin e PMB-ve, të klasifikuara “PMB të rrezikshme”;

b) njohuri për helmueshmërinë e PMB-ve dhe rregullat e përdorimit të sigurt të tyre;

c) njohuri për legjislacionin në fuqi për PMB-të.

6. Gjatë kursit, në të cilin marrin pjesë personat, që kërkojnë të pajisen me dëshmi aftësie, duhet të zhvillohen të paktën 80 orë leksione dhe seminare. Në përfundim të këtij kursi zhvillohet provimi me gojë, pranë komisionit, të ngritur për këtë qëllim.

7. Dëshmia e aftësisë është e vlefshme për 5 vjet nga data e lëshimit dhe shoqërohet me dëshminë shëndetësore, të lëshuar nga komisioni mjeko-ligjor. Ato regjistrohen në një libër të veçantë sipas shtojcës 10, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

8. Dëshmia e aftësisë hartohet sipas modelit të paraqitur në shtojcën nr.11, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

9. Në vendet ku është kryer trajtimi me PMB të klasifikuara “PMB me rrezik të lartë” dhe “PMB të rrezikshme”, ndalohen kalimi, kullotja dhe marrja e ushqimeve për blegtorinë.

10. Në këto territore vendosen, në vende të dukshme, tabela paralajmëruese, me përmasa 50 x 30 cm, të shoqëruara me shënimin “Kujdes, rrezik helmimi”. Këto tabela dhe shënimi i bërë duhet të jenë të qëndrueshme ndaj kushteve atmosferike, të paktën për një periudhë prej 30 ditësh, nga çasti i vendosjes së tyre.

11. Është i ndaluar përdorimi i herbicideve për luftimin e barërave të këqija anës rrugëve kombëtare, hekurudhave, në shtretërit e lumenjve dhe të liqeneve, në parqet publike, në pyjet, në afërsi të gardheve dhe, në përgjithësi, në zonat bujqësore jo të destinuara për kultivimin e bimëve bujqësore.

12. Përcaktimi i zonave, ku ndalohet përdorimi i PMB-ve, të klasifikuara “PMB të rrezikshme” dhe/ose “PMB me rrezik të lartë”, synon pengimin e lëvizjes së tyre drejt vendeve të përcaktuara “të pastra”, cilatdo qofshin kushtet meteorologjike, hidrike dhe pedologjike.

Këto zona u referohen qendrave të banuara, vendeve, që janë afër ujërave, burimeve dhe puseve ujore, parqeve, rezervateve dhe zonave të tjera kombëtare, të mbrojtura, zonave të rritjes së faunës së egër.

13. Kur përdorimi i PMB-ve të klasifikuara “PMB të rrezikshme” dhe/ose “PMB me rrezik, të lartë” në këto zona është i domosdoshëm, duhet të njoftohen, detyrimisht, organet e pushtetit vendor dhe strukturat e mbrojtjes civile për kohën dhe PMB-në, që do të përdoret, si dhe për masat, që duhet të merren për shmangien e efekteve negative në këto zona. Përdorimi PMB-ve, të klasifikuara “PMB të rrezikshme” dhe/ose “PMB me rrezik të lartë” bëhen me miratimin paraprak dhe nën mbikëqyrjen e inspektoratit të mbrojtjes së bimëve, pranë DRBUMK-së, të inspektoratit të mjedisit dhe të përfaqësuesve të pushtetit vendor.

14. Është i ndaluar përdorimi i avionëve për trajtime me PMB, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

15. Është e ndaluar përgatitja e tretësirave spërkatëse afër burimeve, puseve të ujit, rezervuarëve, ujërave të rrjedhshme, gropave, kanaleve, si dhe derdhja e tyre e larja e mjeteve të punës në to.

16. Gjatë përgatitjes së tretësirës për spërkatje duhet të mbahen parasysh këto rregulla:

a) Përzierja të kryhet në mjedis të hapur dhe të ajrosur mirë.

- b) Përgatitja të mos kryhet kur ka erë.
 - c) Të ketë sasi të nevojshme uji për t'u larë, nëse lind nevoja.
 - ç) Të përdoren mjete mbrojtëse të përshtatshme, si: rroba, doreza, syze, maska, këpucë.
 - d) Të llogaritet mirë sasia e solucionit, që do të përdoret, për të mënjeluar derdhjen e solucionit të tepërt në mjedis.
 - dh) Ambalazhi të mos hidhet pas përdorimit, por të grumbullohet për t'u asgjësuar, sipas kërkesave të këtij vendimi.
 - e) Të mënjanohen problemet e mospërputhshmërisë së PMB-ve, në rast përzierjesh të tyre, duke zbatuar me korrektësi etiketën.
 - ë) Të bëhet kujdes në shpëlarjen e mjeteve të trajtimit (pompa të ndryshme etj.) pas përfundimit të punës, që të mos shkaktohet ndotje e mjedisit.
 - f) Të ruhet me kujdes etiketa që, në rast helmimi, të jetë e lexueshme nga mjeku.
17. Në përfundim të punës, vendi, ku përgatitet tretësira dhe bëhet shpëlarja pas punës, punohet me përmbysje, në thellësi 20 cm.
18. Gjatë procesit të punës, PMB-të dhe ambalazhet e tyre, si dhe tretësirat spërkatëse nuk lejohen të lihen për asnjë çast jashtë mbikëqyrjes së përdoruesit.
- Në përfundim të punës ditore, PMB-të që mbesin dhe ambalazhet e tyre kthehen në vendin e ruajtjes, kurse tretësira spërkatëse, pasi të jetë e holluar paraprakisht mbi 5 herë, asgjësohet sipas pikës 17 të këtij kreu.
19. Ndalohet që materiali mbjellës i dezinfektuar me PMB të përdoret si ushqim për njerëz, kafshë e shpendë edhe, në qoftë se ai përpunohet, lahet ose pastrohet, duke përjashtuar rastet kur në etiketë shënohet se lejohet një përdorim i tillë. Materiali mbjellës i dezinfektuar ruhet në vende të veçanta, larg fëmijëve dhe kafshëve.
20. Produktet bimore, që trajtohen me PMB, përdoren për konsum sipas rekomandimeve të dhëna në etiketë ose nga personi, që kryen dezinfektimin.
21. Për të mbrojtur insektet e dobishme dhe veprimtarinë pjalmuese të tyre, është i ndaluar përdorimi i PMB-ve në bimët në lulëzim, qofshin këto të kultivuara apo spontane.
- Trajtimet me PMB mund të kryhen deri tri ditë para lulëzimit, si dhe pas rënies së petaleve, si dhe duke proceduar me prerjen e bimëve spontane në lulëzim, që gjenden nën ose në afërsi të kulturave, që do të trajtohen.
22. Në raste të veçanta të moszbatimit të detyrimit sipas pikës 21 të këtij kreu, përdoruesit e PMB-ve janë të detyruar të njoftojnë blerësit për vendin dhe kohën e trajtimit, me shkrim, tri ditë para, nëpërmjet organeve të pushtetit vendor.
23. Është detyrë e inspektoratit të mbrojtjes së bimëve, pranë DRBUMK-së, që të publikojë listën e toksicitetit të PMB-ve ndaj insekteve pjalmuese, veçanërisht ndaj bletës, dhe ta bëjë atë të njohur për përdoruesit e PMB-ve.

VI. PËRDORUESIT PROFESIONISTË

1. Asnjë person nuk mund të përdorë një PMB, të klasifikuar "PMB me rrezik të lartë", nëse nuk është autorizuar si përdorues profesionist, në përputhje me kërkesat e këtij vendimi.
2. Personi, që kërkon të kualifikohet si përdorues profesionist, duhet të ndjekë një kurs instruktimi në DRBUMK, për përdorimin dhe manipulimin e sigurt të PMB-ve, të klasifikuara "PMB me rrezik të lartë", sipas një tematike, të miratuar nga ministria, që mbulon fushën e bujqësisë.
- Gjatë kursit duhet të zhvillohen të paktën 100 orë leksione dhe seminare, dhe në përfundim të tij të zhvillohet një provim me gojë, pranë komisionit të ngritur për këtë qëllim, pranë DRBUMK-së. PMB-të, që janë regjistruar për t'u përdorur, duhet të jenë në përmbajtjen e kursit të kryer.
3. Pas përfundimit të kursit të instruktimit, sipas pikës 2 të këtij kreu, drejtori i DRBUMK-së autorizon kandidatin të veprojë si përdorues profesionist, duke e pajisur atë me dëshmi aftësie të veçantë.
4. Kur përdoruesi profesionist vepron në kundërshtim me rregullat e përcaktuara në këtë vendim, drejtori i DRBUMK-së anulon dëshminë e aftësisë së veçantë.
- Në këtë rast, ai njofton me shkrim mbajtësin e dëshmisë, duke dhënë, me hollësi, arsyet në bazë të të cilave është marrë një vendim i tillë, si dhe njësitë e tregtimit, me shumicë dhe pakicë, të PMB-ve.
5. Dëshmia e aftësisë së veçantë, e lëshuar nga drejtori i DRBUMK-së në përputhje me pikën 3 të këtij kreu, është e vlefshme për një periudhë jo më shumë se 3 vjet.
- Drejtori i DRBUMK-së mund ta zgjasë këtë afat pas paraqitjes së kërkesës paraprake nga përdoruesi profesionist, kur gjykon se vazhdojnë të plotësohen, nga ky përdorues, kërkesat e këtij

vendimi.

6. Me mbarimin e afatit të dëshmisë së aftësisë së veçantë, drejtori i DRBUMK-së e rinovon atë kur:

- a) ka marrë kërkesën për rinovim;
- b) gjykon se vazhdojnë të plotësohen, nga përdoruesi profesionist, kërkesat e këtij vendimi.

Drejtori i DRBUMK-së mund t'i kërkojë përdoruesit profesionist informacion shtesë, të nevojshëm për të gjykuar për rinovimin ose jo të dëshmisë së aftësisë së veçantë. Drejtori mund ta kushtëzojë rinovimin kur e gjykon të nevojshëm.

7. Kur kërkesa për rinovimin e dëshmisë së aftësisë së veçantë i paraqitet drejtorit sipas pikës 6 të këtij kreu, afati i kësaj dëshmie, të dhënë sipas pikës 5 të këtij kreu, do të vazhdojë deri në çastin, që drejtori do të vendosë për rinovimin ose jo të saj.

8. Në bazë të kërkesës me shkrim të përdoruesit profesionist, drejtori i DRBUMK-së mund ta ndryshojë dëshminë e aftësisë së veçantë të dhënë, kur gjykon që ky ndryshim është i justifikuar.

9. Përdoruesi profesionist garanton të gjitha masat e kërkuara, për të minimizuar rrezikun e efekteve të padëshiruara, në njerëz, kafshë dhe mjedis, që mund të rezultojë nga përdorimi apo ambalazhi i PMB-së, të klasifikuar “PMB me rrezik të lartë”.

10. Drejtori i DRBUMK-së boton çdo vit listën e të gjithë personave, të autorizuar për të vepruar si përdorues profesionist, në përputhje me kërkesat e këtij vendimi.

Kjo listë përmban:

- a) emrin, mbiemrin dhe adresën e përdoruesit profesionist;
- b) datën e dhënies së autorizimit;
- c) listën e PMB-ve, të klasifikuara “PMB me rrezik të lartë”, që autorizohen të përdoren.

VII. TRANSPORTI I PRODUKTEVE PËR MBROJTJEN E BIMËVE

1. Transporti i PMB-ve, të klasifikuara “PMB të rrezikshme” dhe “PMB me rrezik të lartë”, kryhet sipas legjislacionit shqiptar në fuqi për transportin e substancave të rrezikshme.

2. Mjetet, që transportojnë PMB, të klasifikuara “PMB të rrezikshme” dhe “PMB me rrezik të lartë”, duhet të plotësojnë kërkesat teknike, si më poshtë vijon:

- a) Të kenë shenjat dalluese, karakteristike të tyre;
- b) Të kenë sinjalet e ndriçimit dhe gomat në kushte të mira;
- c) Hapësira e brendshme e mjetit të jetë e pastër, e thatë, pa objekte, që mund të dëmtojnë ambalazhin (gozhda apo pjesë të tjera metalike);
- ç) Mbulesa e mjetit të jetë e hapshme, si edhe e padëmtuar dhe e papërshkueshme nga uji, e ndriçimi diellor;

d) Spondat dhe mbulesa të kenë mbyllje shumë të mirë;

dh) Për PMB-të e ndezshme, bazamenti i karrocërisë, spondat dhe mbulesa duhet të jenë prej hekuri, alumini ose të trajtuara me materiale, të qëndrueshme ndaj zjarrit;

e) Të kenë MMI specifike (doreza, rroba, maska, syze, këpucë);

ë) Të jenë të pajisura me mjetet kundër zjarrit.

3. Ndalohet rreptësisht:

- a) transporti i PMB-ve me mjete, që transportojnë njerëz dhe kafshë;
- b) transporti i ushqimeve për njerëz dhe kafshë, së bashku me PMB-të.

4. Transporti i PMB-ve bëhet vetëm në ambalazhet e tyre origjinale.

5. Kur gjatë transportit dëmtohet ambalazhi dhe PMB-ja derdhet, mjeti i transportit duhet të ndalojë dhe drejtuesi i mjetit duhet të marrë masa për ndalimin e rrjedhjes. Për të thithur e dezaktivizuar lëngjet përdoren dherishte, tallash apo gëlqere, fshihet me kujdes dhe asgjësohet PMB-ja e derdhur sipas kritereve të përcaktuara në kreun VIII, të këtij vendimi.

6. Në rast të dëmtimit aksidental të ambalazheve duhet të përdoren MMI (të paktën dorezat).

7. Mjetet e transportit të PMB-ve mund të përdoren për qëllime të tjera vetëm pasi të jenë pastruar dhe larë mirë me ujë, larg qendrave të banuara, burimeve dhe kanaleve të ujit, lumenjve e ujëmbledhësve dhe pas miratimit nga inspektorati sanitar.

8. Ambalazhet më të rënda dhe/ose ato që përmbajnë PMB të lëngëta duhet të vendosen në shtresat e poshtme të ngarkesës.

9. Në raste të ambalazheve me peshë të madhe (mbi 25 kg), mjetet e transportit duhet të jenë të pajisura me kartela transporti.

VIII. ASGJËSIMI I PRODUKTEVE PËR MBROJTJEN E BIMËVE

1. PMB-të, ambalazhet dhe materialet e tjera të caktuara për asgjësim, janë:
 - a) PMB-të të përdorshme, për shkak të skadimit ose për arsye të tjera;
 - b) PMB-të, që kanë rrjedhur, gjatë ruajtjes dhe transportit, dhe materialet e përdorura për thithjen dhe dezaktivizimin e tyre;
 - c) ambalazhet si: fuçi, bidona, shishe, kuti, qese etj., të boshatisura;
 - ç) sendet e ndotura gjatë punës si: pajisje mbrojtëse, enë të ndryshme, mjete pastrimi etj., të cilat nuk mund të përdoren më.
2. Importuesit e PMB-ve të përmendura në shkronjën “a” të pikës 1 të këtij kreu, janë të detyruar t’i largojnë ato nga territori i Republikës së Shqipërisë, ose të bëjnë djegien (inçinerimin) e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Asgjësimi i PMB-ve me djegie (inçinerim), brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, bëhet nga subjekte të specializuara për këtë qëllim, pasi të jenë verifikuar dhe autorizuar nga strukturat përkatëse të Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.
4. PMB-të dhe materialet e përmendura në shkronjat “b”, “c” e “ç” të pikës 1 të këtij kreu, asgjësohen me djegie të zakonshme ose me groposje.

Djegia bëhet në vende të ajrosura, larg njerëzve, kafshëve, banesave a kulturave bujqësore. Ambalazhet e padjegshme lahen, thyhen, çahen ose shtypen dhe groposen.
5. Ndalohet djegia e ambalazheve prej PVC-je, si dhe e ambalazheve të herbicideve.
6. Pikat e groposjes së PMB-ve dhe të materialeve, të përmendura në shkronjat “b”, “c” e “ç” të pikës 1 të këtij kreu, caktohen nga inspektori i mbrojtjes së bimëve, pranë DRBUMK-së, dhe inspektori i mbrojtjes së mjedisit.
7. Groposja bëhet në toka pak ose të papërshekueshme dhe që nuk përmythen, larg ujërave të rrjedhshme dhe baseneve ujore, larg qendrave të banimit, si dhe ndërtesave, ku mbahen kafshët. Gropa bëhet në formë kupe, me diametrin e sipërm deri në 3 m dhe thellësi 1-1.5 m, si dhe vishet me një shtresë argjile 5-10 cm, dhe me gëlqere 2-3 cm. Mbeturinat hidhen në shtresa 10-15 cm, duke i përzier me gëlqere. Gropa mbushet me mbeturina deri 50 cm, nën nivelin e sipërm të saj, edhe pjesa e mbetur mbulohet me dhe ose përzierje argjile dhe gëlqere, si dhe mbillet me shkurre për të shmangur gërryerjet.
8. Zonat e caktuara për groposje mbahen të rrethuara me gardh, ku vendosen tabela paralajmëruese.

IX. RICIKLIMI I AMBALAZHEVE TË PRODUKTEVE TË MBROJTJES SË BIMËVE

1. Njësitë e tregtimit me pakicë të PMB-ve duhet të paguajnë për çdo ambalazh bazë apo dhe më të madh etj., të PMB-së, një vlerë, të barabartë me 10 % të çmimit të PMB-së, të shënuar në faturën e shitjeve të njësisë së tregtimit me shumicë, që e ka furnizuar.
2. Përdoruesit e PMB-ve duhet të paguajnë për çdo ambalazh bazë apo dhe më të madh, të PMB-së, një vlerë, të barabartë me 10 % të çmimit të PMB-së, të shënuar në faturën e shitjeve të njësisë së tregtimit me pakicë, që e ka furnizuar.
3. Përdoruesit e PMB-ve kthejnë ambalazhet e PMB-ve të përdorura pranë njësive të tregtimit me pakicë, ku janë furnizuar, duke u rimbursuar me 10 % të vlerës së mbajtur në faturë.
4. Njësitë e tregtimit me pakicë të PMB-ve i grumbullojnë ambalazhet bosh në një mjedis të veçantë, të ndarë të njësisë, duke i dorëzuar tek ato të shumicës, ku janë furnizuar, në fund të çdo muaji, duke u rimbursuar, gjithashtu, me 10 % të vlerës së mbajtur në faturë.
5. Njësitë e tregtimit me shumicë të PMB-ve i grumbullojnë ambalazhet bosh në një mjedis të veçantë, të ndarë, të magazinës.
6. Në çdo tremujor, inspektorati i mbrojtjes së bimëve, pranë DRBUMK-së, ku ushtrojnë veprimtarinë njësitë e tregtimit të PMB-ve, bën rakordimin e ambalazheve të shpërndara me ato të grumbulluara.
7. Ambalazhet e grumbulluara të njësitë e tregtimit me shumicë, pas rakordimit, trajtohen, si më poshtë vijon:
 - a) Ambalazhet bosh të padëmtuara (përrjashtuar ato bazë) ripërdoren në konfeksionimin e ri të PMB-së;
 - b) Ambalazhet bosh të dëmtuara trajtohen si mbetje helmuese e të dëmshme dhe asgjësohen sipas rregullave të përcaktuara në pikën 4 të kreut VIII të këtij vendimi.

X. KONTROLI CILËSOR I PRODUKTEVE PËR MBROJTJEN E BIMËVE

1. Kontrolli cilësor i PMB-ve bëhet:

a) për PMB-të, që importohen, mostrat e të cilave merren nga inspektorët e karantinës, në pikat e kalimit kufitar, për çdo parti të PMB-së;

b) për PMB-të, që ndodhen në treg, mostrat e të cilave merren nga inspektorët e mbrojtjes së bimëve, pranë DRBUMK-ve, kur ata e shohin të arsyeshme një gjë të tillë.

2. Analizat cilësore të PMB-ve kryhen nga Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV).

3. ISUV-i njofton, me shkrim, për rezultatin e analizave kryeinspektorin e mbrojtjes së bimëve të DRBUMK-së dhe importuesin ose zotëruesin e PMB-ve të analizuar.

4. Shpenzimet për kryerjen e analizave paguhen, në llogarinë e ISUV-it, nga subjekti importues ose zotërues i PMB-ve, në bazë të tarifave të përcaktuara në udhëzimin e përbashkët të ministrisë, që mbulon fushën e bujqësisë, dhe Ministrisë së Financave.

5. Mostra për analizë merret në prani të zotëruesit të mallit.

6. Madhësia e mostrës, që merret nga inspektori për kontrollin cilësor të PMB-ve, duhet të jetë deri në 1 kg, në varësi të madhësisë së ambalazhit, dhe qëllimit të analizës. Ajo formohet nga përzierja dhe homogjenizimi i mostrave të marra. Mostrat merren të paktën në 4 ambalazhe origjinale ose në një numër më të madh, kur madhësia e ambalazheve është më e vogël se 0.250 kg ose litra. Në rastet e lëngjeve, përpara marrjes së mostrës, ena tundet disa herë për të homogjenizuar përmbajtjen. Enët, prej nga merren mostrat, vulosen me shenjën dalluese të marrësit të mostrës dhe pajisen me një kartelë të vogël, që tregon sasinë e tërhequr. Mostra e marrë ndahet në 3 nënndarje, me madhësi të barabarta, ku shënohen A, B e C, që futen në enë të sigurt, të cilat garantojnë ruajtjen e cilësive fiziko-kimike të mostrës. Nënndarja A, pasi vulozet dhe i vihet një kartelë, ku shënohet sasia, emri tregtar i PMB-së dhe data e marrjes, i lihet në dorëzimin zotëruesit të PMB-së. Nënndarja B përdoret për analizat e nevojshme, ndërsa nënndarja C ruhet në ISUV, për analizat e mundshme të rishikimit.

7. Inspektori, pas marrjes së mostrës, harton një raport shoqërues. Një kopje e raportit i lihet zotëruesit të PMB-së.

8. Inspektori i karantinës së mbrojtjes së bimëve në pikat e kalimit kufitar, në zbatim të këtij vendimi, ka detyrë:

a) të kontrollojë dhe verifikojë çdo parti PMB-je, që hyn për t'u përdorur në Republikën e Shqipërisë, dhe i evidenton ato në një libër të veçantë, modeli i të cilit jepet në shtojcën 9, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

b) të ndalojë futjen për qëllim përdorimi në Republikën e Shqipërisë, të PMB-ve të paregjistruara, si dhe kur vëren shkelje në lidhje me etiketimin dhe ambalazhimin e tyre.

9. Kur importuesi, zotëruesi i PMB-ve ose përfaqësuesit e tyre nuk i lejojnë inspektorët e mbrojtjes së bimëve, pranë DRBUMK-ve, të ushtrojnë detyrën në zbatim të këtij vendimi, forcat e Policisë së Shtetit, në bazë të kërkesës së inspektorëve, ndërhyjnë për t'u krijuar atyre kushtet e nevojshme për kryerjen e detyrës.

10. Inspektori i mbrojtjes së bimëve, pranë DRBUMK-së, ka të drejtë të bllokojë një PMB, kur:

a) analizat e kryera nuk përputhen me treguesit cilësorë, të deklaruar për këtë PMB;

b) ajo nuk është e regjistruar sipas legjislacionit në fuqi, për regjistrimin e PMB-ve.

11. Në rast bllokimi sipas shkronjës "a" të pikës 10 të këtij kreu, inspektori i mbrojtjes së bimëve, pranë DRBUMK-së, përgatit një raport, ku përcaktohen mënyrat e asgjësimit ose modifikimit, në mënyrën e përdorimit.

Të gjitha shpenzimet, që lidhen me asgjësimin e PMB-ve, përballohen nga zotëruesi i tyre.

12. Ushqimet me origjinë, bimë dhe shtazore, produktet ushqimore të magazinuara, produktet ushqimore të përpunuara, si dhe lëngjet e pijet e ndryshme, nuk duhet të përmbajnë mbetje të lëndëve vepruese të PMB-ve, të përdorura për mbrojtjen e bimëve, në sasi më të madhe se 0,01 miligram lëndë vepruese për kilogram, të produktit të analizuar.

13. Përgjatimisht nga përcaktimet e pikës 12 të këtij kreu, nivelet e mbetjeve maksimale të lejueshme (MML) të lëndëve vepruese të PMB-ve, të përdorura për mbrojtjen e bimëve të bazuara në:

a) legjislacionin e BE-së;

b) kushtet e vendit tonë, brenda kufijve të përcaktuar nga BE-ja, mbështetur në:

i) kushtet fitosanitare, bujqësore dhe mjedisore, përfshirë ato klimatike, praktikat e mira bujqësore;

ii) rrezikun e ekspozimit të konsumatorit në raport me zakonet e ndryshme të të ushqyerit, përcaktohen me urdhër të ministrit, që mbulon fushën e bujqësisë.

14. Në përcaktimin e vlerës së MML-së të lëndëve vepruese tolerante në ushqimet, të përmendura në pikën 13 të këtij kreu, duhet pasur parasysh:

a) nevoja për të stabilizuar një kufi vlere specifike të dy ose më shumë lëndësh vepruese në të njëjtin ushqim, në raport me vetitë toksikologjike të të njëjtave lëndë, në bazë të rezultateve të

përshtatshme kërkimore-shkencore, të marra nga ISUV-i, mbështetur në bashkëveprimin ndërmjet lëndëve vepruese të ndryshme;

b) përcaktimi në ushqimet e fëmijëve, i një liste lëndësh vepruese, për të cilat mund të stabilizohen nivelet maksimale të mbetjeve jo më të larta se të dhjetat e vlerës së stabilizuar për ushqimet korresponduese, që përdoren të rriturit në përputhje me përshkrimin e shkronjës “a” të kësaj pike, në bazë të rezultateve të përshtatshme kërkimore-shkencore, të marra nga ISUV-ja;

c) vlerësimi i rrezikut të ekspozimit të popullatës në sasi mbetjesh në ushqime në doza më të larta se doza ditore e pranueshme, duke pasur parasysh efektet e dëmshme, të ndryshme për mosha të ndryshme të popullatës, veçanërisht për moshën 3-18 vjeç;

ç) kërkesa aktuale për të parashikuar kufijtë maksimalë të metaboliteve të lëndëve vepruese, si dhe të papastërtive ose të produkteve të degradimit apo që rrjedhin nga reaksionet, me rëndësi toksikologjike a mjedisore.

15. Rregulla më të hollësishme për MML-të, në përputhje dhe me legjislacionin e BE-së, për këtë qëllim, miratohen me urdhër të ministrit, që mbulon fushën e bujqësisë.

XI. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Ngarkohet Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për zbatimin e këtij vendimi.

XII. HYRJA NË FUQI

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

SHTOJCA NR.1

KËRKESË PËR LEJE IMPORTI PËR “PMB-të E RREZIKSHME” DHE “PMB-të ME RREZIK TË LARTË”

1. Emri, mbiemri i personit _____
2. Emri i firmës (kompanisë) _____
3. Punësuar specialistë _____
(Emër, mbiemër, specialiteti)

4. Adresa e zyrave & telefoni _____
1. Kopja e diplomës (e noterizuar) e personit apo shitësit _____
2. Kopja e lejes tregtimit (nëse ka) _____
3. Kopje e licencës së organeve tatimore (e noterizuar) _____
4. Vendi i magazinimit (adresa, telefoni) _____

Datë _____ Emër, mbiemër, firmë

Shtojca Nr. 2

MODELI I LEJES SE IMPORTIT TE "PMB-ve TE RREZIKSHME" DHE PMB-ve ME RREZIK TE LARTE"



NR.
Nr. ____ Prot.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E BUJQESISE, USHQIMIT DHE MBROJTJES SE KONSUMATORIT
STRUKTURA PERGJEGJESE E MBROJTJES SE BIMEVE

LEJE IMPORTI
PER
"PMB-te E RREZIKSHME" DHE "PMB-te ME RREZIK TE LARTE"

Ne mbeshtetje te Nenit 23 te Ligjit Nr.9362, date 24/03/2005, "PER SHERBIMIN E MBROJTJES SE BIMEVE", i ndryshuar,

Subjekti Tregtar _____, me adresse: _____, tel./fax: _____

Lejohet te importoje "PMB te rrezikshme" dhe "PMB me rrezik te larte", qe jane te regjistruara per t'u importuar dhe perdorur ne territorin e Republikes se Shqiperise.

Leshuar me, data, muaji, viti

DREJTUESI I SPMB

Emer, mbiemer, firma

**FORMULARI I AUTODEKLARIMIT PËR IMPORTIN E PMB-ve TË KLASIFIKUARA
“TË TJERA”**

AUTODEKLARIM

Drejtuar: Strukturës përgjegjëse të mbrojtjes së bimëve në MBUMK

TIRANË

Unë i nënshkruari _____ deklaroj që jam banues në _____ me seli
_____, tel/fax — _____ cel. _____ dhe me dokument
identifikimi _____

Deklaroj që jam regjistruar në organet tatimore me nr. NIPT-i _____ dhe me vendim
gjykatë nr. _____ ose me certifikatë regjistrimi në OKR nr. _____ nuk jam në proces
falimentimi, nuk jam në proces hetimi dhe as në proces gjyqësor. Nuk kam asnjë detyrim financiar
(ndaj të tretëve) Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (për subjektet juridike).

Deklaroj që njoh dhe zbatoj ligjin nr.9362, datë 24.3.2005 “Për shërbimin e mbrojtjes së
bimëve”, të ndryshuar me ligjin nr.9908, datë 24.4.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.
9362, datë 24.3.2005 “Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve””.

Do të deklarohet nëse ka pasur ose jo leje të mëparshme për importimin e PMB-ve.

Do të importoj PMB-të (emri tregtar dhe sasia): 1. _____
2. _____ etj.

Nëpërmjet pikës kufitare të hyrjes (emri) _____

Deklaroj që të gjitha të dhënat e mësipërme janë të vërteta dhe në përputhje me legjislacionin
në fuqi.

Datë _____

Emër, mbiemër, firmë

**KËRKESË PËR LEJE TREGTIMI TË “PMB-VE TË RREZIKSHME” DHE “PMB-VE ME
RREZIK TË LARTË”**

1. Emri, mbiemri/ firma _____

2. Profesioni _____

3. Punësuar specialiste _____

4. Adresa, telefoni _____

5. Vendndodhja e magazinave _____

(Adresa, telefoni, përshkrimi topografik i vendndodhjes së magazinave) firma.

Datë _____

Emër, mbiemër, firmë

Shtojca Nr. 5
MODELI I LEJES SE TREGTIMIT TE "PMB-ve TE RREZIKSHME" DHE PMB-ve ME RREZIK TE LARTE"

		NR. _____ Nr. _____ Prot.	
REPUBLIKA E SHQIPERISE MINISTRIA E BUJQESISE, USHQIMIT DHE MBROJTJES SE KONSUMATORIT DREJTORIA RAJONALE E BUJQESISE, USHQIMIT DHE MBROJTJES SE KONSUMATORIT, QARKU _____			
LEJE TREGETIMI PER "PMB-te E RREZIKSHME" DHE "PMB-te ME RREZIK TE LARTE"			
Ne mbeshtetje te Nenit 23 te Ligjit Nr.9362, date 24/03/2005, "PER SHERBIMIN E MBROJTJES SE BIMEVE", i ndryshuar			
Subjekti Tregtar _____, me adrese: _____, tel./fax: _____			
Lejohet te tregtoje "PMB te rrezikshme dhe "PMB me rrezik te larte", qe jane te regjistruara per t'u perdorur ne territorin e Republikes se Shqiperise.			
Leshuar me, Data/muaji/viti		DREJTORI <i>Emer Mbiemer, Firma</i>	

FORMULARI I AUTODEKLARIMIT PËR TREGTIMIN E PMB-VE TË KLASIFIKUARA
“TË TJERA”

AUTODEKLARIM

Drejtuar: Drejtorisë rajonale të bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit

Qarku _____

Unë nënshkruari _____ deklaroj që jam banues në _____ me
seli _____, tel/fax _____ cel. _____ dhe me
dokument identifikimi _____.

Deklaroj që jam regjistruar në organet tatimore me nr. NIPT-i _____ dhe me vendim
gjykatë nr. _____ ose me certifikatë regjistrimi në OKR nr. _____ nuk jam në proces
falimentimi, nuk jam në proces hetimi dhe as në proces gjyqësor. Nuk kam asnjë detyrim financiar
(ndaj të tretëve) Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (për subjektet juridike).

Deklaroj që njoh dhe zbatoj ligjin nr.9362, datë 24.3.2005 “Për shërbimin e mbrojtjes së
bimëve”, të ndryshuar me ligjin nr.9908, 24.4.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9362,
datë 24.3.2005 “Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve””.

Do të deklarohet nëse ka pasur ose jo leje të mëparshme për tregtimin e PMB-ve.

Do të tregtojë PMB-të (emri tregtar dhe sasia): 1 _____
2. _____ etj.

Deklaroj që të gjitha të dhënat e mësipërme janë të vërteta dhe në përputhje me legjislacionin
në fuqi.

Datë _____

Emër, mbiemër, firmë

SHTOJCA NR.7

LIBRI I SHITJES ME SHUMICË TË “PMB-VE TË RREZIKSHME” DHE “PMB-VE ME RREZIK TË LARTË”

Emri tregtar i PMB-së _____

Nr.	FURNIZUAR				SHITUR					
	Nga ka ardhur	Nr. i fletëhyrjes	Sasia kg/lit	Data	Emri, mbiemri i blerësit	Emri i subjektit tregtar	Nr. i lejes tregtimit	Sasia kg/lit	Nr.fletë daljes	Data

Shënim. Këto të dhëna ruhen në magazinë për një afat prej 5 vjetësh.

SHTOJCA NR. 8

LIBRI I SHITJES SË “PMB-VE TË RREZIKSHME” DHE “PMB-ve ME RREZIK TË LARTË” TEK PËRDORUESI I FUNDIT

Nr.	FURNIZUAR				SHITUR					
	Emri i subjektit	Nr. i fletëhyrjes	Sasia kg	Data e furnizimit	Emri, mbiemri i blerësit	Firma	Lloji dhe nr. dëshmisë së aftësisë	Sasia e shitur kg/lit	Data e shitjes	Vërejtje

SHTOJCA NR. 9

LIBRI I KONTROLLIT TË PMB-VE NË PIKËN E KALIMIT KUFITAR _____

Nr.	Data e kalimit	Emri tregtar i PMB	Emri i lëndës vepruese	Numri dhe data e regjistrimit	Vendi i origjinës	Nr. i partisë së mallit	Prodhuesi/aplikuesi	Emri i blerësit/firmës importuese	Sasia kg/lit	Mjeti, targa	Vërejtje	Inspektori karantin

SHTOJCA NR. 10

LIBRI I DËSHMIVE TË AFTËSISË
DRBUMK e qarkut _____

Nr.	Emri, mbiemri	Vendbanimi	Data e lëshimit të dëshmisë	Numri i dëshmisë	Lloji i dëshmisë	Firma

MODELI I DËSHMISË SË AFTËSISË



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT
DREJTORIA RAJONALE E BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË
KONSUMATORIT

DËSHMI AFTËSIE

Nr. _____

I lëshohet zj/z. emri, emri i babës, mbiemri, e cila/i cili është instruktuar dhe ka fituar njohuritë e mjaftueshme për të punuar me PMB-të e klasifikuara “PMB të rrezikshme”.

Lëshuar më: _____

Shënim. Dëshmia është e vlefshme për 5 vjet nga data e lëshimit dhe shoqërohet me dëshminë shëndetësore të lëshuar nga komisioni mjeko-ligjor.

MBAJTËSI I DËSHMISË
()

PËR KOMISIONIN
Kryetari
()

MODELI I DËSHMISË SË AFTËSISË SË VEÇANTË



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT
DREJTORIA RAJONALE E BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË
KONSUMATORIT

DËSHMI AFTËSIE E VEÇANTË

(Lëshohet për përdoruesit profesionistë)

Fotografia

Nr. _____

I lëshohet zj./z. emri, emri i babës, mbiemri, e cila/i cili është instruktuar posaçërisht dhe ka fituar njohuritë e mjaftueshme për të punuar si përdorues profesionist me PMB-të e klasifikuara “PMB-të me rrezik të lartë”.

Lëshuar më: _____

Shënim. Dëshmia është e vlefshme për 3 vjet nga data e lëshimit dhe shoqërohet me dëshminë shëndetësore të lëshuar nga komisioni mjeko-ligjor dhe që rinovohet çdo vit.

MBAJTËSI I DËSHMISË
()

PËR KOMISIONIN
Kryetari
()

SHTOJCA NR.13

PASQYRA E INSPEKTIMEVE TË KRYERA

Nr.	Subjekti tregtar i inspektuar	Lloji i inspektimit (i planifikuar i rastit)	Objekti i inspektimit	Materiali i mbajtur (procesverbal, aktkontroll etj.)	Nr. i materialit të mbajtur	Data e kryerjes së inspektimit	Masa administrative e dhënë	Ekzekutimi i masës administrative

SHTOJCA NR. 14


PASQYRA E INSPEKTIMEVE TË KRYERA
SUBJEKTI TREGTAR _____

Nr.	Lloji i inspektimit (i planifikuar, i rastit)	Objekti i inspektimit	Materiali i mbajtur (procesverbal, aktkontroll etj.)	Nr. i materialit të mbajtur	Data e kryerjes së inspektimit	Masa administrative e dhënë	Nënshkrimi i inspektorit që ka kryer inspektimin

Shënim. Kjo pasqyrë mbahet në njësinë e tregtimit me shumicë dhe pakicë të PMB-ve.

SHTOJCA NR. 15

MJETE TË MBROJTJES INDIVIDUALE (MMI)

			
Doreza mbrojtese te detyrueshme	Mbrojtese e detyrueshme e rrugeve te frymemarrjes	Kepuce te detyrueshme sigurie	Veshje mbrojtese e detyrueshme per trupin

VENDIM

Nr.1211, datë 27.8.2008

PËR KUOTAT FINANCIARE TË USHQIMIT NË MENSA E KONVIKTE, BURSAT E

SHTETIT DHE PAGESAT E NXËNËSVE DHE TË STUDENTËVE, NË INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE, PËR VITIN SHKOLLOR 2008-2009

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 63 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, të nenit 29 të ligjit nr.8872, datë 29.3.2002 “Për arsimim dhe formim profesional në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 57 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar, të ligjit nr.8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Nxënësit, që ndjekin studimet në institucionet arsimore publike dhe studentët, që ndjekin një program studimi, të ciklit të parë, me kohë të plotë, në institucionet arsimore publike, mund të përfitojnë bursë dhe përfitime të tjera, të parashikuara në këtë vendim, nga buxheti vjetor, i miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

2. Përfitojnë bursë, brenda kuotave dhe kriterëve të përcaktuara në këtë vendim:

2.1 Sipas kriterit ekonomik (nxënës/studentë)

a) Nxënësit/studentët, që vazhdojnë studimet larg vendbanimit të tyre, në largësinë mbi 5 km, dhe plotësojnë kriterin ekonomik, sipas pasqyrës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

b) Nxënësit, që banojnë në fshat, pa shkollë 9-vjeçare, brenda rrezes prej 5 km, e që vendosen në konvikt publik.

c) Nxënësit/studentët, që kanë përfutur statusin e jetimit dhe që plotësojnë kriterin ekonomik.

ç) Nxënësit/studentët, të cilët kanë humbur kujdestarinë prindërore, me vendim gjykatë, të formës së prerë, dhe që plotësojnë kriterin ekonomik.

d) Secili nga studentët bashkëshort, me fëmijë, që plotëson kriterin ekonomik e që vendoset në konvikt publik.

dh) Fëmija, nxënës apo student, që ka statusin e invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik, dhe që plotëson kriterin ekonomik.

2.2 Sipas rezultateve të arritura (nxënës/studentë)

a) Nxënësit e arsimit të mesëm profesional, që kanë mbaruar vitin shkollor pararendës, me të gjitha notat 10-ta.

b) Studentët, që regjistrohen në vitin e parë të shkollës së lartë, e që kanë mbaruar shkollën e mesme, me Medalje Ari.

c) Studentët, që regjistrohen në vitin e parë të shkollës së lartë, e që janë shpallur nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës më të mirët e Maturës Shtetërore. Për vitin 2008 janë, gjithsej, 30 (tridhjetë). Kjo kategori studentësh përfiton bursë vetëm për vitin shkollor 2008-2009.

ç) Studentët, që kanë mbaruar vitin akademik, pararendës, me të gjitha notat 10-ta.

d) Studentët, që vazhdojnë studimet në degët matematikë dhe fizikë, në vitet e dyta e lart dhe që e kanë përfunduar vitin akademik, pararendës, me notën mesatare mbi 8-të.

2.3 Jashtë kriterit ekonomik (nxënës/studentë)

Fëmija, nxënës apo student i punonjësit të policisë, që ka humbur jetën në krye e për shkak të detyrës. Në fillim të çdo viti akademik, Ministria e Brendshme dërgon në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës listën për këtë kategori.

2.4 Sipas degëve përparësore për zhvillimin e ekonomisë (nxënës)

Nxënësit, të cilët vazhdojnë studimet në shkollat profesionale, në degët bujqësore, veterinare, pyjore dhe në ndërtim, në vitet e dyta e lart, dhe që kanë mbaruar vitin akademik, pararendës, me notën mesatare mbi 8-të.

3. Nxënësit dhe studentët nuk e përfitojnë ose/dhe e humbasin të drejtën e përfitimit të bursës, kur:

a) janë ndarë nga trungu familjar;

- b) familjet e tyre ushtrojnë veprimtari private;
- c) vazhdojnë studimet në një program të dytë studimi;
- ç) shpallen mbetës dhe humbasin vitin shkollor, për arsye të rezultateve jokalue.

4. Ministria e Arsimit dhe Shkencës harton planin e shpërndarjes së bursave, për drejtoritë arsimore rajonale (DAR) dhe zyrat arsimore (ZA), për vitet e para, sipas kuotave të miratuara (për nxënës/studentë).

DAR-ja/ZA-ja, pas këshillimit me strukturat e pushtetit vendor, bëjnë planin e shpërndarjes së bursave në bashki dhe komuna, në përputhje me kërkesat e paraqitura, paraprakisht, prej tyre për kategoritë sipas pikës 2.1, të këtij vendimi.

5. Bashkitë dhe komunat, bazuar në planin e përcaktuar për to, nga DAR-ja/ZA-ja, vendosin me këshillat e tyre për dhënien e bursave, sipas kritereve ekonomike, të përcaktuara në këtë vendim, duke u dhënë përparësi nxënësve/studentëve nga shtresat sociale në nevojë, për trajtimin me bursë të plotë ose, në pamundësi, trajtimin me gjysmëbursë.

5.1 Bashkitë dhe komunat, detyrimisht, u dërgojnë, në rrugë zyrtare, drejtorive arsimore rajonale apo zyrave arsimore përkatëse, vendimet për dhënien e bursave, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës.

5.2 Drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore u dërgojnë institucioneve të arsimit të lartë, bashkive dhe komunave, që menaxhojnë konviktet, listën emërore të nxënësve/ studentëve, që do të trajtohen me bursë, së bashku me vendimet origjinale të këshillave bashkiake apo të komunave. Një kopje e kësaj liste dërgohet edhe në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

6. Bursat e nxënësve, për vitet e dyta e lart, rishqyrtohen dhe miratohen, çdo vit, nga këshilli i bashkisë dhe komunës, sipas vendndodhjes, territoriale e administrative të konvikteve, ku janë vendosur nxënësit konviktorë.

Nxënësit, që në vitin e parë kanë përfituar bursë, me vendim të këshillit të bashkisë apo komunës, ku kanë vendbanimin e përhershëm, e marrin këtë bursë deri në përfundim të viteve të shkollimit, nëse atyre nuk u ndryshojnë kriteret ekonomike dhe nuk rezultojnë mbetës.

Bursat për nxënësit, të cilët studiojnë në shkollat profesionale, në degët parësore për zhvillimin e ekonomisë, si në degët bujqësore, veterinare, pyjore dhe në ndërtim, në vitet e dyta e lart, dhe që kanë mbaruar vitin akademik, pararendës, me notën mesatare mbi 8-të, planifikohen dhe shpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Numri total i bursave, të planifikuara për nxënësit, që përfitojnë sipas pikës 2.4 të këtij vendimi, për vitin shkollor 2008-2009, është 190, brenda planit të bursave të miratuara po për këtë vit. DAR-ja/ZA-ja janë të detyruara t'i dërgojnë informacion për numrin e nxënësve, që përfitojnë bursën, sipas këtij kriteri, Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

7. Bursat e studentëve, për vitet e dyta e lart, rishqyrtohen dhe miratohen, çdo vit, nga institucionet e arsimit të lartë. Studentët e viteve të dyta e lart, që nuk kanë përfituar bursë dhe plotësojnë kriterin ekonomik, mund ta përfitojnë atë brenda planit të bursave, të përcaktuar sipas këtij vendimi.

Numri i bursave për këtë kategori studentësh dhe për studentët, që përfitojnë bursë sipas pikës 2.2 të këtij vendimi, është deri në 130, në shkallë vendi, brenda numrit të përgjithshëm të bursave, të dhëna për vitin shkollor 2008-2009. Institucionet e arsimit të lartë paraqesin, në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, kërkesat për studentët, që përfitojnë bursë, sipas pikës 2.2 të këtij vendimi. Ministria e Arsimit dhe Shkencës harton planin e shpërndarjes, të cilin ia dërgon për ekzekutim institucioneve të arsimit të lartë.

Studentët, që, gjatë vitit të parë, kanë përfituar bursë me vendim të këshillit të bashkisë apo komunës, ku kanë vendbanimin e përhershëm, e marrin këtë bursë deri në përfundim të viteve të shkollimit, nëse atyre nuk u ndryshojnë kriteret ekonomike dhe nuk rezultojnë mbetës.

8. Nga plani i bursave, të miratuara për vitin shkollor 2008-2009, Bashkisë së Tiranës i jepen 15 (pesëmbëdhjetë) bursa të larta, për studentët, që vijnë nga familjet/shtresat sociale në nevojë, invalidët, paraplegjikë dhe tetraplegjikë, duke i përjashtuar nga kriteri, që të vazhdojnë studimet jashtë vendbanimit të tyre.

9. Nxënësit/studentët, që kanë përfituar statusin e jetimit, nxënësit e Institutit të Fëmijëve që nuk Dëgjojnë dhe të Institutit të Fëmijëve, që nuk Shikojnë, përfitojnë falas veshmbathje, libra, fletore etj., sipas pasqyrës nr.6, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Kjo kategori nxënësish/studentësh përjashtohet nga detyrimet e tarifave të shërbimeve të ndryshme, që ofrojnë shkollat.

9.1 Nxënësve/studentëve, që kanë përfituar statusin e jetimit, u sigurohen falas, nga fondet e shkollave përkatëse, shërbimi shëndetësor, shërbimi dentar dhe medikamentet, pas paraqitjes së librezës dhe të kartës shëndetësore, si dhe të epikrizës, nga qendra spitalore e rrethit.

9.2 Nxënësit jetimë e përfitojnë bursën edhe gjatë pushimeve verore, si dhe vetëm një vit, kur humbasin vitin shkollor, për rezultate jokaluëse.

9.3 Fëmijët dhe mësuesit e institucioneve të arsimit special, pa konvikt, trajtohen falas nga shteti, me një vakt ushqim (drekë), me vlerë deri në 150 (njëqind e pesëdhjetë) lekë në ditë.

10. Fondet buxhetore për mbulimin e shpenzimeve për bursat, si dhe numri i bursave për studentët administrohen nga institucionet e arsimit të lartë dhe u paguhen, çdo muaj, me kalim, në numrin e llogarisë bankare të çdo studenti.

10.1 Fondet buxhetore për mbulimin e shpenzimeve për bursat e nxënësve, “Kuota ushqimore”, si dhe numri i bursave për nxënësit administrohen nga bashkia/komuna, sipas vendndodhjes, territoriale dhe administrative, të konvikteve, ku janë vendosur nxënësit konviktorë, dhe u jepen nxënësve vetëm me ushqim, në konvikt.

11. Niveli i bursës për nxënësit dhe studentët jepet sipas pasqyrave nr.2 e nr.3, ndërsa kuota financiare ushqimore ditore është sipas pasqyrave nr.4 e nr.5, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

12. Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, për vitin shkollor 2008-2009, i jepen 190 bursa, për nxënësit, dhe 1 600 bursa, për studentët, për të gjitha kategoritë e parashikuara në pikat 1 e 2 të këtij vendimi.

13. Efektet financiare për vitin shkollor 2008-2009 të përballohen nga Buxheti i Shtetit, miratuar për këtë vit, për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, si dhe nga Buxheti i Shtetit, që do të miratohet për vitin 2009, për pjesën e vitit 2009.

14. Afati përfundimtar për shqyrtimin dhe miratimin e bursave për vitet e para është data 15 dhjetor 2008, për të gjitha kategoritë e shkollave, ndërsa për vitet e dyta e lart, është data 30 nëntor 2008.

Në raste të veçanta, kur këshilli i bashkisë apo i komunës nuk mund ta miratojë, brenda këtij afati, numrin e bursave të dhëna, mbetet kompetencë e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës shqyrtimi i këtyre vendimeve, rast pas rasti.

15. Vendimi nr.658, datë 10.10.2007 i Këshillit të Ministrave “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, bursat e shtetit dhe pagesat e nxënësve dhe studentëve në institucionet arsimore publike, për vitin shkollor 2007-2008”, shfuqizohet.

16. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, DAR-të/ZA-të dhe institucionet e arsimit të lartë e njësitë e pushtetit vendor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha
PASQYRA NR.1

KUSHTET EKONOMIKE TË NXËNËSIT DHE STUDENTIT PËR DHËNIEN E BURSËS

(Viti mësimor 2008-2009)

Të ardhurat mujore për frymë në lekë

Nr.	Përbërja familjare	Bursa	Gjysmëbursa	Me pagesë
	Për qytetin			
1	Për familjet me 2 persona	Deri 3200 lekë	3200-4600 lekë	Mbi 4600 lekë
2	Për familjet me 3 persona	Deri 3100 lekë	3100-4500 lekë	Mbi 4500 lekë
3	Për familjet me 4 persona	Deri 3000 lekë	3000-4400 lekë	Mbi 4400 lekë

4	Për familjet me 5 persona	Deri 2900 lekë	2900-4300 lekë	Mbi 4300 lekë
5	Për familjet me 6 persona	Deri 2800 lekë	2800-4200 lekë	Mbi 4200 lekë
6	Për familjet me 7 persona	Deri 2700 lekë	2700-4100 lekë	Mbi 4100 lekë
7	Për familjet me 8 persona	Deri 2600 lekë	2600-4000 lekë	Mbi 4000 lekë

Shënim: Nxënësit dhe studentët nga fshati përfitojnë bursë, kur familja përfiton ndihmë ekonomike, në varësi të masës së kësaj ndihme, brenda planit të akorduar për secilën njësi të pushtetit vendor.

PASQYRA NR.2

NIVELI I BURSËS PËR NXËNËSIT (Viti mësimor 2008-2009)

Në lekë

Nr.	Kategoritë e nxënësve sipas shkollave	Bursat dhe pagesat e nxënësit	Financimi nga shteti	Financimi nga nxënësit	Për kuotë ushqim	Shpenzime vetjake
1	Shkollat 9-vjeçare dhe të mesme					
	Bursa	6000	6000		5800	200
	Gjysmëbursa	6000	3000	3000	5800	200
	Me pagesë	6000		6000	5800	200
2	Shkolla e Mjeshtërisë Sportive dhe nxënësit e arsimit special					
	Bursa	6500	6500		6300	200
	Gjysmë bursa	6500	3750	3750	6300	200
	Me pagesë	6500		6500	6300	200
3	Nxënësit jetim	6500	6500		6300	200

PASQYRA NR.3

NIVELI I BURSËS PËR STUDENTËT (Viti mësimor 2008-2009)

Në lekë

Nr.	Kategoritë e studentëve	Bursat dhe pagesat e studentëve	Financimi nga shteti	Financimi nga studenti	Kuota e ushqimit	Kuota e fjetjes
1	Universitetet, Akademia e Arteve dhe shkollat e tjera të larta					
	Bursa	8500	8500		6500	2000
	Gjysmë bursa	8500	4250	4250	6500	2000
	Me pagesë	8500	0	8500	6500	2000

2	Akademia e Edukimit Fizik dhe Sporteve					
	Bursa	9000	9000		7000	2000
	Gjysmëbursa	9000	4500	4500	7000	2000
	Me pagesë	9000	0	9000	7000	2000

PASQYRA NR.4

Kuotat financiare sipas normave në natyrë për ushqimin e nxënësve (Viti mësimor 2008-2009)

Nr	Emërtimi	Njësia matëse	Norma ditore	Vlera energjetike (në kcal)	Çmimi mesatar	Vlera ditore
1	Bukë	Gram	400	1117	80	32
2	Makarona	“	30	107	50	1.5
3	Oriz	“	30	109	80	2.4
4	Sheqer	“	40	157	70	2.8
5	Fasule	“	30	93	180	5.4
6	Perime	“	130	27	84	10.9
7	Fruta	“	100	42	950	9.5
8	Vaj	“	30	270	220	6.6
9	Gjarpë	“	20	152	500	10
10	Mish	“	90	130	600	54
11	Djathë	“	25	40	350	8.7
12	Reçel	“	20	93	300	6
13	Vezë	Kokërr	1	42	12	12
14	Qumësht	Gram	200	98	40	8
15	Patate	“	200	170	60	12
16	Nënprodukte mishi	“	30	100	400	12
	Kuota ditore			2746		193.8

Shënim. Është e domosdoshme që nxënësi të marrë kuotën ditore në lekë dhe në kalori, ndërsa gramaturat dhe lloji i ushqimit mund të ndryshojë sipas menuve të ndryshme, sipas çmimeve që ofrohen nga konkurrenca e prokurimeve dhe ndikimit të faktorëve të tjerë (gramaturat e normës ditore në pasqyrë janë përdorur për efekt planifikimi).

PASQYRA NR.5

KUOTAT FINANCIARE SIPAS NORMAVE NË NATYRË PËR USHQIMIN E STUDENTËVE (VITI MËSIMOR 2008-2009)

Nr.	Emërtimi	Njësia matëse	Norma ditore	Vlera energjetike (në kcal)	Çmimi mesatar	Vlera
1	Bukë	Gram	400	1117	80	32
2	Makarona	“	30	107	50	1.5
3	Oriz	“	40	145	80	3.2
4	Sheqer	“	40	157	70	2.8
5	Fasule	“	40	124	180	7.2
6	Perime	“	130	27	84	10.9
7	Fruta	“	100	42	950	9.5
8	Vaj	“	40	360	220	8.8
9	Gjarpë	“	20	152	500	10
10	Mish	“	98	140	600	58.8

11	Djathë	“	42	66	350	14.7
12	Reçel	“	44	190	300	13.2
13	Patate	“	200	170	60	12
14	Qumësht	“	200	98	40	8
15	Vezë	Kokërr	1	42	12	12
16	Nënprodukte mishi	Gram	30	100	400	12
	Kuota ditore			3037		216.6

PASQYRA NR.6

KUOTAT FINANCIARE TË VESHMBATHJES (VITI MËSIMOR 2008-2009)

Nr.	Emërtimi	Kuota financiare në lekë e veshmbathjes për një vit kalendarik
1	Për fëmijët e arsimit special	7 000 (shtatë mijë)
2	Për jetimët	10 000 (dhjetë mijë)

VENDIM
Nr.1212, datë 27.8.2008

PËR DHËNIEN E BURSIVE PËR NXËNËSIT E SHKOLLËS SË MESME PROFESIONALE “PETER MAHRINGER”, SHKODËR, PËR VITIN SHKOLLOR 2008-2009

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 63 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, të ligjit nr.9522, datë 25.4.2006 “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Austrisë, për bashkëpunimin në fushat e kulturës, të arsimit dhe shkencës”, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministria e Arsimit dhe Shkencës të japë 60 (gjashtëdhjetë) bursa studimi, nga të cilat 30 (tridhjetë) bursa për nxënës të viteve të para dhe 30 (tridhjetë) bursa për nxënës të viteve të dyta të shkollës së mesme profesionale “Peter Mahringer”, Shkodër, për vitin shkollor 2008-2009.

2. Masa e bursës të jetë 680 euro për nxënës në vit, për shlyerjen e tarifës mujore të shkollimit dhe mbulimin e kostos për tekstet mësimore.

3. Buxheti për mbulimin e këtyre bursave t’i kalojë nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës drejtorisë arsimore rajonale, Shkodër.

4. Miratimi i këtyre bursave bëhet nga bordi i fondacionit shkollor austriak, në mbështetje të kriterëve ekonomike dhe të rezultateve të arritura nga secili nxënës/aplikant.

5. Bordi i fondacionit shkollor austriak, pas miratimit të bursave, e dërgon dokumentacionin përkatës në drejtorinë arsimore rajonale, Shkodër, e cila, pas konfirmimit të nxënësve, që përfitojnë bursë, e kalon masën e bursës në llogarinë personale të secilit nxënës.

6. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti vjetor, i miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

7. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM
Nr.1215, datë 9.7.2008

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I NËNSTACIONIT
TË GJIROKASTRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i nënstacionit të Gjirokastrës, sipas tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të KESH sh.a.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, dhe pronarët e kulturave bujqësore, të dëmtuara, të kompensohen në lekë, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për një sipërfaqe 4 200 (katër mijë e dyqind) m², tokë bujqësore, arë, dhe kultura të ndryshme bujqësore, në shumën e përgjithshme 1 260 000 (një milion e dyqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë.

4. Fondi 1 260 000 (një milion e dyqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë, për kompensimin e pronarëve të shpronësuar, të përballohet nga fondet e KESH sh.a., të miratuara për koston lokale për shpronësimet.

5. Shpenzimet procedurale, në shumën 158 000 (njëqind e pesëdhjetë e tetë mijë) lekë, të përballohen nga KESH-sh.a., kërkuesi për shpronësim.

6. Procedura e shpronësimit të fillojë brenda muajit korrik 2008 dhe të përfundojë brenda tremujorit të katërt të po këtij viti.

7. Punimet për ndërtimin e këtij nënstacioni të përfundojnë në tetor të 2008.

8. Paga të bëhet pas paraqitjes së dokumenteve të pronësisë, sipas ligjit nr.8561, datë 22.12.1999.

9. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe KESH sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË NËNSTACIONIT TË GJIROKASTRËS

RRETHI: GJIROKASTËR

KOMUNA: GERHOT

Lloji i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet: tokë bujqësore, pemtore

Shpronësimi definitiv										
Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Lloji i pasurisë	Nr. kadastral	Nr. i pasurisë	Sipërfaqja e shpronësuar në m ²	Çmimi lekë/m ²	Vlera në lekë	Ad
1.	Çajup	Dino	Muhameti	Pemtore	194	193/2	1900	300	570000	Gerhot
2.	Merseli	Karafil	Rapi	Pemtore	194	193/3	2300	300	690000	Gerhot
	Shuma						4200		126000	

Shpenzimet procedurale konsistojnë në:

1. Publikimi në 2 gazeta me shpërndarje kombëtare Koha Jonë dhe Standard, për një periudhë njëjavore për çdo publikim, të cilat kapin vlerën 133000 (një qind e tridhjetë e tremijë) lekë.

2. Bazuar në pikën 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.126, datë 23.3.2000 “Për përbërjen dhe procedurat e punësimit të komisionit të posaçëm të shpronësimit”, është parashikuar një masë shpërblimi për 5 anëtarët e komisionit në vlerë totale prej 25 000 (njëzet e pesëmijë) lekë.

3. Totali i shpenzimeve të kryera nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, por që realisht do të mbulohen nga “KESH” sh.a., Tiranë, si subjekt kërkues për këtë shpronësim, janë në vlerën totale 158 000 (një qind e pesëdhjetë e tetëmijë) lekë.

VENDIM
Nr.1219, datë 3.9.2008

**PËR NJË SHITESË DHE NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.335, DATË 2.9.1997 TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE “PËR LËSHIMIN E PASAPORTAVE DIPLOMATIKE DHE TË
SHËRBIMIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr.8668, datë 23.11.2000 “Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.335, datë 2.9.1997 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen shtesa dhe ndryshime, si më poshtë vijon:

1. Në fund të pikës 3 shtohet emërtimi:

“- Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.”.

2. Në shkronjën “A” të pikës 4, emërtimi “- Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1220, datë 3.9.2008

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT, TË CIKLIT TË DYTË, PRANË
UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS, NË VITIN AKADEMIK 2008-2009**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 42, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, pranë Universitetit Politeknik të Tiranës, të programeve të mëposhtme të studimit, të ciklit të dytë, sipas fakulteteve:

a) Në Fakultetin e Inxhinieri Elektrike:

i) Programi i studimit “Inxhinieri elektrike”, me profil:

- Automatizimi i industrisë;

- Energjetikë.

Në përfundim të këtij programi do të lëshohen diplomat e mëposhtme:

- Diplomë e nivelit të dytë, DND, në inxhinieri elektrike, profili automatizimi i industrisë;

- Diploma e nivelit të dytë, DND, në inxhinieri elektrike, profili energjetik.

b) Në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike:

i) Programi i studimit “Inxhinieri mekanike”, me profile:

- Energjetikë;

- Konstruktion makinash dhe mjete lëvizëse;

- Prodhim dhe menaxhim industrial.

Në përfundim të këtij programi do të lëshohen diplomat e mëposhtme:

- Diplomë e nivelit të dytë, DND, në inxhinieri mekanike, me profil energjetik;

- Diplomë e nivelit të dytë, DND, në inxhinieri mekanike, me profil konstruksion makinash me mjete lëvizëse;

- Diplomë e nivelit të dytë, në inxhinieri mekanike, me profil prodhim dhe menaxhim industrial.

ii) Programi i studimit “Inxhinieri materiale”, me profile:

- Materiale;

- Metalurgji dhe fonderi.

Në përfundim të këtij programi do të lëshohen diplomat e mëposhtme:

-Diplomë e nivelit të dytë, DND, në inxhinieri materiale, profili materiale;

- Diplomë e nivelit të dytë, DND, në inxhinieri mekanike, profili metalurgji dhe fonderi.

2. Programet e studimit të ciklit të dytë realizohen me 120 kredite dhe zgjatja normale e tyre është dy vite.

3. Këto programe studimi të fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2008-2009.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2008, miratuar për Universitetin Politeknik të Tiranës.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti Politeknik i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM

Nr.1221, datë 3.9.2008

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT, TË CIKLIT TË DYTË PRANË UNIVERSITETIT BUJQËSOR TË TIRANËS, NË VITIN AKADEMIK 2008-2009

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, pranë Universitetit Bujqësor të Tiranës, të programeve të mëposhtme të studimit, të ciklit të dytë, sipas fakulteteve:

a) Në Fakultetin e Bujqësisë dhe Mjedisit:

i) Programi i studimit “Inxhinieri agrare”, me profile:

- Hortikulturë;

- Mbrojtja e bimëve;

- Prodhimi bimor;

- Zootekni;

- Akuakulturë.

Në përfundim të këtij programi do të lëshohen diplomat e mëposhtme:

- Diplomë e nivelit të dytë, DND, në inxhinieri agrare, me profil hortikulturë;

- Diplomë e nivelit të dytë, DND, në inxhinieri agrare, me profil mbrojtja e bimëve;

- Diplomë e nivelit të dytë, DND, në inxhinieri agrare, me profil prodhim bimor;

- Diplomë e nivelit të dytë, DND, në inxhinieri agrare, me profil zootekni;

- Diplomë e nivelit të dytë, DND në inxhinieri agrare, me profil akuakulturë.

ii) Programi i studimit “Inxhinieri agromjedis”, në përfundim të cilit lëshohet diplomë e nivelit të dytë, DND, në inxhinieri agromjedis.

b) Në Fakultetin e Bioteknologjisë dhe Ushqimit, programi i studimit “Inxhinieri agroushqimor”, me profile:

- Vreshtari-enologji;
- Teknologji agroushqimore.

Në përfundim të këtij programi do të lëshohen diplomat e mëposhtme:

- Diplomë e nivelit të dytë, DND, në inxhinieri agroushqimore, me profil vreshtari-enologji;
- Diplomë e nivelit të dytë, DND, në inxhinieri agroushqimore, me profil teknologji agroushqimore.

2. Programet e studimit të ciklit të dytë realizohen me 120 kredite dhe zgjatja normale e tyre është dy vite.

3. Këto programe studimi të fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2008-2009.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2008, miratuar për Universitetin e Bujqësor të Tiranës.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti Bujqësor i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM

Nr.26, datë 4.9.2008

PËR TAKSAT KOMBËTARE

Në zbatim të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, si dhe në zbatim të ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, Ministri i Financave

UDHËZON:

1. Dispozita të përgjithshme

1.1 Në zbatim të nenit 6 të ligjit nr.9975, datë 28.7.2008, taksat kombëtare derdhen 100% në Buxhetin e Shtetit. Taksat vjetore arkëtohen nga agjentët e taksave dhe transferohen në Buxhetin e Shtetit brenda datës 30 të muajit, kur janë arkëtuar taksat.

Kur detyrimi për pagimin e taksave lind në gjashtëmujorin e parë të vitit, taksat paguhen në masën 100%, ndërsa kur detyrimi lind për herë të parë në 6-mujorin e dytë, taksat paguhen në masën 50 për qind të shumës së taksës vjetore të përcaktuar në ligj.

1.2 Në zbatim të nenit 5 të ligjit, agjentët e taksave janë të detyruar të bëjnë vjeljen e taksave dhe të derdhin në buxhet shumat e vjela sipas ligjit për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë.

1.3 Në zbatim të nenit 8, agjentët e taksave, të përcaktuar në nenin 5 të ligjit, përfitojnë një përqindje të caktuar të arkëtimeve nga taksat. Punonjësit e taksave në drejtoritë rajonale të tatimeve bëjnë aktrakordime me agjentët e taksave për taksat e vjela, si dhe përcaktojnë shumën që u takon agjentëve të taksave. Aktin e rakordimit, i cili do të jetë i firmosur nga inspektori i taksave, përfaqësuesi i agjentit të taksave, si dhe nga kryetari i drejtorisë rajonale të tatimeve, agjentët e taksave duhet ta paraqesin në degën e thesarit të rrethit ku ushtrojnë aktivitetin e vjeljes së taksave. Modeli i aktit të rakordimit dhe përmbajtja e tij do të jetë sipas formularit nr.1 bashkëngjitur këtij udhëzimi. Kriteret e përdorimit të komisioneve që iu jepen agjentëve të taksave janë përcaktuar në ligj dhe akte nënligjore dhe përdoren:

- a) në formën e shpërblimit mbi pagën, për vështirësi në punë, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi;
- b) në formën e pagës, për rastet kur merren punonjës të rinj, për përballimin e vjeljes së taksave;
- c) për mekanizimin, informatizimin, përmirësimin e kushteve të punës, si dhe përballimin e shpenzimeve për vjeljen e taksave.

2. Dispozita të veçanta

Sipas llojit të taksave, kemi këto lloje taksash:

2.1 Taksat portuale

Taksat portuale paguhen nga anijet shqiptare ose të huaja sa herë prekin portet e Republikës së Shqipërisë. Masa e kësaj takse është 1 euro. Taksat portuale paguhen me mbërritjen e anijes në port, dhe janë të vlefshme për të gjithë kohën që anija qëndron në port.

Ngarkohen me vjeljen e këtyre taksave kapiteneria e porteve, e cila i vjel këto taksa drejtpërdrejt ose nëpërmjet agjencive detare shtetërore ose private.

Në kuptimin e ligjit, nëse anija për kryerjen e veprimeve të saj do të prekë edhe një port tjetër shqiptar, paguan vetëm në portin e parë. Pra, nëse një anije mbërrin në Durrës dhe shkarkon një pjesë të mallit dhe në të njëjtin rejs shkarkon pjesën tjetër në Shëngjin, atëherë kjo anije paguan vetëm në portin e parë. Në qoftë se një anije që vjen nga një port i huaj shkarkon në portin e Durrësit ku paguan taksat portuale dhe ngarkon në këtë port një mall të ri, të cilin e shkarkon në një port tjetër shqiptar si p.sh. në Vlorë, atëherë kjo anije do të paguajë taksat portuale edhe në portin e Vlorës.

Taksat portuale paguhen në secilin port të Shqipërisë, pavarësisht nëse anija mbërrin nga jashtë ose nga një port tjetër i shtetit shqiptar. Anije të subjekteve shqiptare do të konsiderohen anijet që janë në pronësi të vet dhe anijet e marra me qira.

2.2 Taksa vjetore e qarkullimit rrugor të mjeteve

Taksës vjetore të qarkullimit rrugor të mjeteve i nënshtrohen të gjitha mjetet e klasifikuara sipas shtojcës nr.1 të ligjit, që janë të regjistruara në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor. Kjo taksë arkëtohet nga qendrat e kontrollit teknik të drejtorive rajonale të shërbimeve të transportit rrugor.

Pagesa e taksës bëhet në çdo kohë, por gjithnjë para kryerjes së kontrollit teknik të mjetit. Vlera e taksës është vjetore, pavarësisht nga momenti në të cilin ajo paguhet. Edhe mjetet e reja, pavarësisht nga momenti i targimit të tyre, paguajnë vlerën e plotë të taksës. Pagesa e kësaj takse shoqërohet me faturë, me pullën e taksës, si dhe biletën me numër serial, në të cilën, përveç të dhënave të mjetit, shënohet edhe vlera e taksës së paguar. Zotëruesi i mjetit e vendos pullën e taksës në xhamin e përparmë të mjetit për të lehtësuar ushtrimin e kontrollit vizual nga organet e Ministrisë së Brendshme dhe Policia Tatimore. Këto dokumente prodhohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe shpenzimet përballohen nga ky institucion në zbatim të nenit 8, pika 3, shkronja “c” të ligjit. Dokumentet e mësipërme duhet të përmbajnë elemente të sigurisë së lartë, për të shmangur falsifikimin e tyre.

Drejtoritë rajonale të transportit rrugor bëjnë regjistrimin ditor të arkëtimit të taksës që shërben si dokument bazë për rakordimin e pagesës së taksës me drejtoritë rajonale të tatimeve. Regjistrimi bëhet në një regjistër të veçantë, forma dhe përmbajtja e të cilit janë sipas formularit nr.2 bashkëngjitur këtij udhëzimi. Këto drejtori, brenda datës 31 janar të çdo viti, dërgojnë në drejtoritë rajonale të tatimeve, listën e mjeteve të regjistruara, duke shënuar edhe datën e fundit të kontrollit teknik të mjetit.

Drejtoritë rajonale, deri në datën 15 të muajit pasardhës, evidentojnë dhe dërgojnë në drejtoritë rajonale të tatimeve dhe në strukturat e Ministrisë së Brendshme, listën e mjeteve që nuk janë paraqitur për të bërë kontrollin teknik dhe që për rrjedhojë nuk kanë paguar taksën.

2.3. Taksa e mjedisit

Në bazë të nenit 3 pika 3 të ligjit, taksa e mjedisit përbëhet nga këto komponentë:

- a) Taksa e importimit të mjeteve të përdorura;
- b) Taksa e karbonit për benzinën, benzolin dhe gazoilin;
- c) Taksa për ambalazhet plastike të lëngjeve (bidona, shishe plastike e kuti të plastifikuara të të gjitha formave dhe përmasave), të mbushura, të prodhuara në vend dhe të importuara, për produktet: ujë, pije freskuese, lëngje frutash e perimesh, qumësht dhe nënproduktet e tij, vajra ushqimore, vajra lubrifikante dhe detergjente.

2.3.1 Taksa e importimit të mjeteve të përdorura

Kjo taksë paguhet nga importuesi i mjetit të përdorur, në momentin e zhdoganimit të tij. Agjent tatimor për vjeljen e taksës së importimit të mjeteve të përdorura është Drejtoria e Përgjithshme e Doganave nëpërmjet degëve të saj doganore.

Degët doganore bëjnë llogaritjen e taksës së importimit të mjeteve të përdorura sipas llojeve të

mjeteve dhe viteve të përdorimit:

Për mjetet me 10 ose me shumë vite përdorimi, taksa është sipas pikës 3.1.1 të nenit 4 të ligjit:

a) mjetet e transportit me motor, sipas përcaktimeve të kreut 8702 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave për transportin e jo më shumë se 20 personave përfshirë shoferin dhe mjete të tjera për transportin e mallrave të kreut 8704 të NK me peshëmbajtje deri në 5 tonë, 128 000 lekë;

b) mjetet e transportit me motor, sipas përcaktimeve të kreut 8702 të Nomenklaturës së Kombinuar të mallrave për transportin e jo më shumë se 20 personave përfshirë shoferin, dhe mjete të tjera për transportin e mallrave të kreut 8704 të NK me peshëmbajtje mbi 5 tonë, 160 000 lekë;

c) traktorët rrugorë, që klasifikohen në kreun 8701 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, 40 000 lekë.

Për mjetet me më pak se 10 vite përdorimi, taksa është sipas pikës 3.1.2 të nenit 4 të ligjit:

a) mjetet e transportit me motor, sipas përcaktimeve të kreut 8702 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, për transportin e jo më shumë se 20 personave përfshirë shoferin, dhe mjete të tjera për transportin e mallrave të kreut 8704 të NK me peshëmbajtje deri në 5 tonë, 80 000 lekë;

b) mjetet e transportit me motor, sipas përcaktimeve të kreut 8702 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, për transportin e jo më shumë se 20 personave përfshirë shoferin, dhe mjete të tjera për transportin e mallrave, sipas përcaktimeve të kreut 8704 të NK, me peshëmbajtje mbi 5 tonë, 100 000 lekë;

c) traktorët rrugorë, sipas përcaktimeve të kreut 8701 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, 48 000 lekë.

Për autoveturat, llogaritja e taksës bëhet sipas pikës 3.1.3 të nenit 4 të ligjit.

Llogaritja e taksës bëhet sipas formulës:

Taksa fikse x cilindrata e motorit x koeficientin e viteve të përdorimit. Taksa fikse për çdo autoveturë me benzinë caktohet 20000 (njëzet mijë lekë) dhe për çdo autoveturë të naftës 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë.

Cilindrata e motorit është volumni i dhomës së djegies së motorit të shprehur në centimetër kub dhe jepet në certifikatën shoqëruese të mjetit.

Vite përdorimi quhet diferenca ndërmjet vitit kur mjeti hyn në qarkullim të lirë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, me vitin e prodhimit.

Shembull 1: Llogaritja e taksës për një autoveturë tip benz 190 i prodhuar në vitin 2002 me naftë dhe i importuar në vitin 2007, bëhet si më poshtë:

- Koeficienti sipas ligjit është 0.0029;

- Cilindrata e motorit është 1930 centimetër kub;

- Taksa fikse 25 000 lekë; - $1930 \times 25\,000 \times 0.0029 = 139\,925$ lekë.

Shembull 2: Llogaritja e taksës për një autoveturë, e cila në momentin e zhdoganimit ka mbi 10 vjet prodhimi, për të njëjtin tip autoveture si në shembullin e mësipërm, bëhet si më poshtë:

- $1930 \times 25\,000 \times 0.0048 = 231\,600$ lekë.

Në çdo rast, llogaritja e taksës së importimit të autoveturave të përdorura, do të bëhet sipas formulës së pikës 3.1.3 të nenit 4 të ligjit. Në qoftë se nga llogaritjet sipas pikës 3.1.3 të nenit 4 të ligjit, taksa e importimit të autoveturave të përdorura rezulton më e vogël se nivelet e parashikuara në pikat “3.1.1” dhe “3.1.2” të ligjit taksa do të mbahet sipas këtyre pikave.

Degët e doganës të gjitha arkëtimet nga taksat i evidentojnë në regjistër, sipas formularit nr.3 bashkëngjitur këtij udhëzimi.

2.3.2 Taksa e karbonit për benzinën, benzolin dhe gazoilin

Taksa e karbonit është caktuar në masën 0.5 lekë për litër për benzinën dhe benzolin dhe 1 lekë për litër për gazoilin. Për benzinën, benzolin dhe gazoilin e importuar vjelja e taksës së karbonit bëhet nga degët e doganave. Kjo taksë paguhet në momentin e deklarimit në doganë të benzinës, benzolit apo gazoilit të importuar.

Taksa e karbonit për benzinën, benzolin dhe për gazoilin e importuar nuk përfshihet në bazën e taksueshme për efekt të llogaritjes së taksës doganore, TVSH-së dhe akcizës.

Taksat e karbonit për benzinën, benzolin dhe gazoilin e importuar, për mallrat që vendosen në

regjimin e pezullimit tatimor ose doganor, nuk aplikohet në momentin e vendosjes në këto regjime, por në momentin kur mallrat çlirohen nga këto regjime.

Për gazolin, benzinën dhe benzolin e prodhuar në vend, prodhuesit deklarojnë dhe paguajnë taksën e karbonit në degën përkatëse të tatimeve në momentin e lëvizjes së këtyre produkteve nga vendi i prodhimit.

Shumat e arkëtuara nga kjo taksë derdhen çdo 5 ditë në llogarinë e degës përkatëse të tatimeve.

2.3.3 Taksa për ambalazhet plastike të lëngjeve

Taksa e ambalazheve plastike të lëngjeve të importuara apo të prodhuara në vend llogaritet në masën 2 lekë për copë për ambalazhet e lëngjeve me kapacitet mbi 1.5 litra dhe 1 lek për copë për ambalazhet me kapacitet të barabartë ose më të vogël se 1.5 litra. Për mallrat e importuara kjo taksë arkëtohet nga Drejtoria Përgjithshme e Doganave nëpërmjet degëve të saj, në momentin e zhdoganimit të mallit.

Taksat e ambalazheve plastike të lëngjeve nuk përfshihen në bazën e taksueshme për efekt të llogaritjes të taksës doganore, TVSH-së dhe akcizës.

Taksa për ambalazhet plastike të lëngjeve për mallrat që vendosen në regjimin e pezullimit tatimor ose doganor nuk aplikohet në momentin e vendosjes në këto regjime, por në momentin kur mallrat çlirohen nga këto regjime.

Për ambalazhet plastike bosh të lëngjeve, të cilat importohen, taksa nuk llogaritet në momentin e zhdoganimit të mallit, por te prodhuesi i lëngjeve.

Për mallrat me ambalazhe plastike të prodhuara në vend, vjelja e taksës bëhet nga degët e tatimeve, në momentin e shitjes së mallrave. Prodhuesit e lëngjeve me ambalazhe plastike bëjnë llogaritjen e taksës të cilën më pas e derdhin në llogarinë e drejtoritë rajonale përkatëse të tatimeve. Brenda datës 14 të çdo muaji subjektet dorëzojnë në drejtorinë rajonale të tatimeve formularin e deklarimit sipas modelit nr. 4 bashkëngjitur këtij udhëzimi.

2.4 Taksa e rentës minerare

Taksa e rentës minerare përcaktohet në pikën 4 të nenit 4 të ligjit nr nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare” dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave, në zbatim të tij.

- Në rastin e shitjes së pasurisë minerare për konsum final në tregun e brendshëm, renta minerare paguhet për llogari të organeve tatimore, nga subjekti zotërues i lejes së shfrytëzimit të mineralit.

- Në rastin kur subjekti zotërues i lejes së shfrytëzimit bën edhe eksportin e mineralit, renta minerare paguhet në degët doganore në çastin e bërjes së deklaratës së eksportit. Pagesa e kësaj takse, në rastin e eksportit, evidentohet me mandatar këtë.

- në rastin kur subjekti, zotërues i lejes së shfrytëzimit, ia shet produktin minerar një subjekti tjetër të regjistruar pranë organeve tatimore konform legjislacionit në fuqi, por jo për konsum final brenda vendit, por ky i fundit e eksporton mineralin, taksa e rentës minerare do të paguhet si nga subjekti zotërues i lejes së shfrytëzimit pranë organeve tatimore, ashtu edhe nga subjekti eksportues, në momentin e bërjes së deklaratës doganore të eksportit. Në këtë rast, organet tatimore janë të detyruara, brenda 15 ditësh nga paraqitja e dokumentacionit të kërkuar nga subjekti eksportues, të rimbursojnë subjektin për vlerën e taksës së rentës minerare së paguar në doganë. Dokumentet e nevojshme që subjekti eksportues të përfitojë rimbursimin janë:

1. Kopje e mandatar këtimit të doganës për taksën e paguar në doganë, si dhe kopje të mandat arkëtimit të taksës së subjektit shitës të mineralit, me qëllim që të tregohet se kjo taksë është paguar nga të dy subjektet e lidhura.

2. Kopje të deklaratës doganore;

3. Kopje të faturës tatimore me TVSH të blerjes së mineralit nga subjekti shitës;

4. Kopje e kontratës së shitjes së lidhur ndërmjet subjektit blerës dhe njëkohësisht eksportues dhe shitësit.

Vlera e saktë në përqindje e rentës së pasurisë minerare, sipas vlerës se tregut, për çdo mineral apo grup mineralesh, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, 15-ditëshin e parë të muajit shkurt të çdo viti.

Zotëruesi i lejes së shfrytëzimit të mineraleve, brenda datës 15 të muajit pasardhës, duhet të derdhë për llogari të degës së tatimeve ku ushtron aktivitetin e tij, taksën e rentës së pasurisë të specifikuar

në shtojcën nr.2 të ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare” dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave të zbatim të këtij ligji, sipas vlerës së tregut të mineraleve të shitura konsumatorëve gjatë muajit.

Për të përcaktuar vlerën e tregut të këtyre mineraleve, me qëllim që të llogaritet renta e pasurisë minerare, veprohet si vijon:

1. Vlera e tregut të mineralit të shitur te konsumatori gjatë muajit kalendarik jepet:

a) Në rastin kur produkti i shitur është mineral i nxjerrë nga miniera, vlera e tregut të mineralit është e barabartë me çmimin e shitjes së produktit;

b) Në rastin kur produkti përfundimtar i shitur është përpunuar më tej, vlera e tregut të mineralit është e barabartë me çmimin e shitjes së produktit përfundimtar gjatë muajit kalendarik minus:

- shpenzimet e pasurimit, shkrirjes dhe të rafinimit që janë kryer mbi mineralin;

- shpenzimet e transportit nga miniera në fabrikën e pasurimit, shkritore ose impiantet e rafinimit të mineralit;

- të gjitha shpenzimet e tjera, të cilat nuk janë zbritur në pikën 1 dhe që lidhen me koston e pasurimit, shkrirjes ose rafinimit.

2. Çmimi i shitjes nënkupton:

a) Në qoftë se produkti eksportohet, çmimi i shitjes është FOB Shqipëri.

b) në qoftë se produkti nuk eksportohet, çmimi i shitjes është i barabartë me çmimin e shitjes brenda vendit minus:

- shpenzimet e transportit të produktit nga pika e prodhimit deri në pikën e shitjes FOB Shqipëri;

- shpenzimet e tjera të shitjes nëse ka të tilla.

Zotëruesi i lejes dorëzon brenda datës 5 të çdo muaji, formularin tip nr.5 bashkëngjitur këtij udhëzimi. Ai duhet të japë gjithashtu kur është e nevojshme edhe të dhënat e mëposhtme:

a) Emrin dhe përshkrimin e mineralit;

b) Emrin dhe adresën e zotëruesit të lejes dhe administratorit;

c) Sasinë e mineralit të prodhuar gjatë muajit të kaluar

d) Një konfirmim lidhur me prodhimin e muajit të kaluar dhe shpërndarjen e tij (p.sh. te konsumatorët, fabrikat e pasurimit, shkritoret, rafineritë ose të depozituar);

e) Sasinë e mineralit të shitur te konsumatorët gjatë muajit kalendarik, emrat dhe adresat e blerësve dhe kontratat e shitjes, të cilat duhet të përmbajnë veçoritë mbi natyrën, cilësinë dhe përmbajtjen e mineraleve;

f) Emrat dhe vendndodhjet e fabrikave të pasurimit, shkritoreve dhe rafinerive ku është shpërndarë minerali;

g) Koston për ton të fabrikës së pasurimit, shkritoreve dhe rafinerive ku është shpërndarë minerali gjatë muajit kalendarik;

h) Koston për ton të transportit të mineralit të shitur gjatë muajit kalendarik, e detajuar kjo në rastin kur transporti i mineralit kryhet duke kaluar në disa hallka transporti;

i) Shpenzimet e shitjes nëse ka dhe që janë kryer gjatë muajit kalendarik;

j) Një llogaritje të detajuar të rentës së pasurisë minerare gjatë muajit kalendarik.

Zotëruesi i lejes së shfrytëzimit duhet të mbajë pranë minierës librat përkatës të prodhimit të mineralit nga zona e lejuar dhe të gjithë dokumentacionin që lidhet me to.

Të gjitha të dhënat mbi prodhimin, transportin, përpunimin dhe shitjen, përfshirë këtu dhe kontratat e shitjes, kontrollohen nga degët e tatimeve dhe doganave.

2.4.2 Në rast se organet, tatimore dhe doganore, vërejnë se çmimet e deklaruara të shitjes së produkteve minerare janë me të ulëta se çmimet e tregut, këto organe duhet t'i referohen dosjes me të dhënat e disponueshme për vlerën e eksporteve minerare, për përcaktimin e vlerës së shitjes së produkteve minerare, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 7 të këtij vendimi.

Si burim informacioni për krijimin e dosjes me të dhënat e disponueshme për vlerën e eksporteve minerare shërbejnë burime të tilla, si çmimet e tregjeve ndërkombëtare, të dhënat statistikore të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, investigimi i tregut, brenda dhe jashtë vendit, kryer nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve

Natyrore, çmimet e produkteve minerare, të ngjashme, që eksportohen, çmimet e paraqitura në deklaratën e eksportit, për subjektet e tjera, që veprojnë në të njëjtën industri.

Përcaktimi sipas pikës 7 të këtij vendimi bëhet nga një komision, i përbërë nga specialistë me përvojë të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, (të cilët caktohen nga ministrat përkatës) e më pas dërgohen për miratim pranë komisionit *ad-hoc*, krijuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr.686, datë 2.11.2005.

2.5 Taksa e akteve dhe e pullës

Shtetasit, për çdo dokument të lëshuar nga zyrat e gjendjes civile, janë të detyruar të paguajnë taksën sipas shtojcës nr.3 të ligjit. Dokumentet e gjendjes civile janë të vlefshme vetëm kur kanë pullën e taksës të vulosur me vulën e gjendjes civile. Vjelja e këtyre taksave bëhet nga zyrat e gjendjes civile Vjelja e taksës për kartën e identitetit bëhet me mandatar këtëmi.

Derdhja e taksave të vjelura në llogarinë e organit tatimor do të bëhet jo më vonë se 5 ditë nga data e arkëtimit.

2.6. Taksa për regjistrimin e lojërave të fatit, për kazinotë dhe për garat sportive që zhvillohen në hipodrom.

Taksa për regjistrimin e lojërave të fatit, kazinotë dhe për garat sportive që zhvillohen në hipodrom paguhet vetëm njëherë në momentin e fillimit e veprimtarisë dhe të regjistrimit të saj.

2.7. Taksa për ushtrimin e veprimtarisë së peshkimit

Kjo taksë është vjetore dhe me vjeljen e saj ngarkohet Drejtoria e Politikave të Peshkimit në ministrinë përgjegjëse për ujërat. Pagesat e kësaj takse bëhen sipas shtojcës nr.4 të ligjit. Detyrimi për pagimin e kësaj takse lind në momentin e marrjes së lejes për ushtrimin e aktivitetit të peshkimit.

Lejet për ushtrimin e aktivitetit të peshkimit jepen mbasi të jetë paguar taksa përkatëse. Kjo taksë derdhet në llogarinë e drejtorive rajonale të tatimeve brenda 5 ditëve nga momenti i arkëtimit.

3. Përfshirjet nga taksat kombëtare

1. Përfshihen nga pagimi i taksës vjetore të qarkullimit rrugor të mjeteve:

a) mjetet në pronësi të ambasadave dhe organizatave ndërkombëtare, që gëzojnë statusin diplomatik, të akredituara në Republikën e Shqipërisë, duke zbatuar parimin e reciprocitetit;

b) personat fizikë ose juridikë, të cilët deklarojnë brenda muajit janar të vitit në vazhdim se nuk do të qarkullojnë automjetet në pronësi të tyre gjatë këtij viti kalendarik dhe dorëzojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor targën dhe lejen e qarkullimit të automjetit, paguajnë vetëm 20 për qind të taksës.

c) Invalidët dhe veteranët e luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar, invalidët e punës, të verbrit, invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë që e fitojnë këtë status në bazë të ligjeve përkatëse, kur mjeti është në zotërimin e tyre dhe përdoret vetëm për nevojat e tyre personale dhe jo për aktivitet privat. Sipas nenit 16/1 të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, si dhe të nenit 4 të ligjit 8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbrit”, kur invalidi i punës dhe personi i verbër ushtron veprimtari private, nuk përfshihet nga pagimi i kësaj takse.

2. Përfshihen nga pagimi i taksës së mjedisit për komponentin e taksës së importimit të mjeteve të përdorura, invalidët dhe veteranët e luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar, invalidët e punës, të verbrit, invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë që e fitojnë këtë status në bazë të ligjeve përkatëse, kur mjeti importohet për zotërimin e tyre dhe përdoret vetëm për nevojat e tyre personale dhe jo për aktivitet privat.

Përfshirja nga pagimi i taksave të mësipërme bëhet vetëm kur veprimet bëhen në emër të veteranit të luftës, invalidit të punës a të luftës, të verbrit, sëmurëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

Veterani i luftës, invalidi i luftës apo i punës, personat e verbër, si dhe të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë duhet të paraqesin pranë agjentit tatimor librezën përkatëse, së bashku me dokumentin e identifikimit të personit që përfiton përfshirimin nga taksa.

3. Përfshihen nga pagimi i taksës së akteve dhe të pullës:

a) veprimet zyrtare, që kërkohen nga autoritetet e huaja, në bazë reciprociteti;

b) regjistrimi i lindjeve dhe i vdekjeve, si dhe shënimet në regjistrat e gjendjes civile.

4. Të gjitha përfshirjet do të shënohen në një regjistër të veçantë, ku do të jetë shënuar emri,

mbiemri, si dhe ekstremet e librezës sipas formularit nr.6, bashkëngjitur këtij udhëzimi.

4. Tarifat e shërbimit

Në zbatim të nenit 11 të ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare” nivelet e tarifave të shërbimit, për tarifat të cilat arkëtohen nga organet tatimore dhe doganore, do të përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave, ndërsa tarifat të cilat mbliidhen nga institucione të tjera, do të përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Financave dhe titullarit të institucioneve respektive.

5. Zbatimi i udhëzimit

Ngarkohet me zbatimin e këtij udhëzimi Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, degët e tyre dhe agjentët përkatës.

6. Shfuqizime

Udhëzimi nr.1, datë 30.1.2006 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar”, shfuqizohet.

7. Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCEVE
Ridvan Bode

Formulari nr.1

AKTRAKORDIMI MUJOR I TAKSËS SË _____ PËR MUAJIN _____

Në mijë lekë				
Lloji i taksës	Shuma e taksave të arkëtuara	Shuma e taksave të derdhura në llogarinë e tatimeve	Diferenca e pagesës (+ose-)	Komisioni i agjentit tatimor

Drejtoria Rajonale e Tatimeve

Agjenti tatimor

REGJISTRI DITOR I TAKSAVE VJETORE TË QARKULLIMIT RRUGOR PËR VITIN

Nr.	Numri i		Data	Emri mbiemri i pronarit	Targa	Lloji i mjetit	Tonazhi ose nr.vend	Vlera e taksës (në lekë)	Numri i grupit të mjetit (sipas faturës)
	Faturës	M.arket							

Drejtoria rajonale e transportit rrugor

REGJISTRI DITOR I TAKSËS SË IMPORTIMIT TË AUTOMJETEVE TË PËRDORURA

Nr.	Emri i zotëruesit të mjetit	Lloji i mjeteve	Viti i prodhimit të mjetit	Lloji i karburantit	Masa e taksës	Shuma e taksave të paguara

Dega e doganës

Formular nr.4

DEKLARIMI I TAKSËS SË AMBALAZHEVE PLASTIKE

Shoqëria _____

DEKLARATË

Për muajin _____

Nr.	Lloji i ambalazhit sipas volumit	Sasia në copë	Taksa për njësi	Detyrimi i pagesës së taksës	Derdhur në tatime
1					
2					
3					
4					
5					
6					
7					
8					
9					
Etj.					

Shuma					
-------	--	--	--	--	--

Administratori

Formular nr.5

AKTRAKORDIMI I TAKSËS SË RENTËS MINERARE PËR MUAJIN_____

Subjekti_____

Lloji i mineralit	Sasia e prodhuar	Sasia e shitur	Subjekti blerës adresa	Taksa e paguar

Administratori
(Emri, mbiemri)

Data_____

Formular nr.6

REGJISTRI I PËRJASHTIMEVE NGA PAGESAT E TAKSAVE

Nr. rendor	Emri i takspaguesit	Statusi ligjor i përfashtimit	Lloji i taksës	Vlera e taksës

Agjenti tatimor

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 10.9.2008
Doli nga shtypi më 11.9.2008

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Ilar”
Tiranë, 2008

Çmimi 44 lekë